

1 E martë, 18 nëntor 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari hyn në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Sekretar i
6 Seancës ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi, të nderuar
8 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit. Ju faleminderit, të nderuar
11 Gjykatës

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vë re që të
13 katër të akuzuarit janë të pranishëm në sallën e gjyqit sot.

14 Sot do të vazhdojmë me dëshminë e dëshmitarit të Thaçit,
15 1DW-007.

16 Përpara se sa të fillojmë me dëshminë e këtij dëshmitari
17 Trupi Gjykues dëshiron që të trajtojë disa çështje paraprake.

18 Më konkretisht, më 30 tetor 2025 ZPS-ja kërkoi që të
19 shtonte ose të zëvendësonte versione aktualisht të pranura të
20 shumë dokumenteve me versionet e rishikuara të cilat janë
21 nxjerrë së fundi në provat materiale të pranura. Ekzistojnë
22 disa kërkesa individuale. Mbrojtësja dhe Mbrojtësi i Viktimave
23 do të kenë mundësinë që të komentojnë lidhur me secilën prej
24 këtyre kërkesave pasi të lexohen dokumentet përkatëse.

25 Së pari, ZPS-ja kërkon që të zëvendësohet P00515_ET.77 me

008879-00881-ET_extract_F03214 që janë nxjerrë në Paketën 1815. Trupi Gjykses vëren se pjesëzat e reja përfshijnë vetëm faqet e dokumentit që janë paraqitur për pranim nga ZPS-ja në parashtrimin F03114-A02, dokumenti 2 dhe që janë pranuar përmes Vendimit F03214.

Së dyti, ZPS-ja kërkon që të shtohet dokumenti 066769-066769-ET në provën ekzistuese P01616 që është nxjerrë në paketën 1814. Trupi Gjykses vëren se dokumenti i ri përmban një përkthim të shënimeve të bëra me dorë nga dëshmitari lidhur me provën P01616.

Së treti, ZPS-ja kërkon që të zëvendësohet P0310_ET me SPOE00056467-SPOE00056467_ET e Rishikuar. Dokumenti është nxjerrë në Paketën 1793. ZPS-ja parashtron se dokumenti i rishikuar pasqyron me saktësi versionin në origjinal që është pranuar nga Trupi Gjykses dhe se faqja SPOE00056467, në paragrafin katër, përfshin një pjesë që mungonte nga përkthimi i pranuar në P00310_ET. Trupi Gjykses vëren se fjal që i është shtuar përkthimit të rishikuar është "Bujar".

Së katërti, ZPS-ja kërkon që të shtohet 125893-02-TR/125893-02-TR-ET që është nxjerrë në Paketën 1757, në P04221/P04221.1. Trupi Gjykses vëren se dokumentet e reja janë transkriptet në anglisht dhe në shqip të një videoje që është pranuar në Vendimin F03214 si prova P04221, së bashku me dosjen në arkivë të *Associated Press* dhe që është pranuar si prova P04221.1.

1 Së pesti, ZPS-ja kërkon që të zëvendësohet P01712.1_ET me
2 060111-TR-ET [Sipas përkthimit], Pjesa 1, e Rishikuar RED.
3 Dokumenti i rishikuar është nxjerrë në Paketën 1793. ZPS-ja
4 parashtrohet se faqja 16, rreshti 6 i këtij transkripti në
5 anglisht është rishikuar për të pasqyruar me saktësi
6 origjinalin e këtij dokumenti në shqip që tashmë është
7 pranuar.

8 Së gjashti, ZPS-ja kërkon që P01086-ET/P01086_AT të
9 zëvendësohet me 061427-03-TR-Rishikuar dhe 061427-03-TR-
10 Rishikuar-ET, të cilat janë nxjerrë në Paketën 1813. ZPS-ja
11 parashtrohet se dokumentet e reja pasqyrojnë me më shumë saktësi
12 videon e pranuar, përfshirë këtu edhe korrigjimin e një
13 reference të pasaktë për "Calin", në faqen që duhet të
14 zëvendësohet me "Çeliku".

15 Së shtati, ZPS-ja kërkon që faqja SPOE00231058 e provës
16 P01091_ET të zëvendësohet nga faqja SPOE00231058 e dokumentit
17 SPOE00231037-SPOE0 - ju kërkoj ndjesë; atëherë edhe një herë -
18 -SPOE0023118-ET_E rishikuar. Faqja e rishikuar është nxjerrë
19 në Paketën 1814. ZPS-ja parashtrohet që paragrafi 2 i dokumentit
20 është rishikuar për të pasqyruar me saktësi origjinalin në
21 shqip që është pranuar tanimë si provë.

22 Atëherë ishin shumë pika për t'u lexuar, por megjithatë
23 tani për momentin dua t'ju pyes nëse keni kundërshtime për
24 pranimin dhe për shtimet ose korrigjimet të cilat ne sapo i
25 lexuam.

1 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, na duhet që t'i
2 kontrollojmë dhe një herë disa prej këtyre dokumenteve, kështu
3 që do kërkonim pak kohë gjatë pushimit në mënyrë të tillë që
4 ta bëjmë këtë gjë, nëse është e mundur.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
6 pushimin si zakonisht në orën 11:00 deri në 11:30. Besoj që
7 gjatë kësaj periudhe keni kohë të mjaftueshme që t'i shikoni,
8 t'i kontrolloni këto dokumente; është një opsion i mundur ky;
9 është në rregull ky si opsion?

10 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit shumë, i nderuar
11 Gjykatës.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]

13 Tani do të vazhdojmë me dëshminë e dëshmitarit të Thaçit
14 1DW-007. Ju kujtoj palët dhe pjesëmarrësve për masat që janë
15 autorizuar për këtë dëshmitar në parashtimin F03558 në pajtim
16 me rregullën 107.

17 Znj. Sekretare, ju lutemi sillni dëshmitarin në sallë.

18 [Dëshmitari vijon dëshminë]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi,
20 Gjenerali Clark.

21 DËSHMITARI: [Mikrofon i çaktivizuar].

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjenerali
23 Clark, sot do të vazhdojmë me dëshminë tuaj. Ju kujtoj që t'i
24 përgjigjeni pyetjeve qartë, me fjali të shkurtra. Në qoftë se
25 nuk e kuptoni një pyetje të caktuar lirisht mund t'i kërkon

1 avokatit që ta përsërisë pyetjen ose thoni që nuk e kuptuat
2 pyetjet në mënyrë të tillë që pala përkatëse që bëjë sqarimet
3 përkatëse. Po ashtu ju lutem na thoni se cila është baza e
4 njohurive lidhur me faktet dhe rrethanat për të cilat do të
5 pyeteni.

6 Ju kujtoj që jeni ende nën detyrimin për të thënë të
7 vërtetën, ashtu siç deklaruat në deklaratën solemne.

8 Ju lutem, gjithashtu, flisni pranë mikrofonit, bëni një
9 pauzë prej pesë sekondash përpara se sa ti përgjigjeni
10 pyetjeve dhe mundohuni që të flisni ngadalë në mënyrë të tillë
11 që t'ju ndjekin përkthyesit.

12 Edhe në qoftë se e ndjeni të nevojshme që të bëni një
13 pushim, lirisht mund të na e thoni ne këtë gjë për të bërë
14 organizimet përkatëse.

15 Tani do të vazhdojmë me pyetjet e Prokurorit. Ju lutemi,
16 dëgjojini pyetjet me vëmendje.

17 Z. Halling, e keni ju fjalën.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

19 DËSHMITARI: WESLEY CLARK [Vijon]

20 Pyetje të palës tjetër nga z. Halling:

21 [Vazhdim]

22 PY. Mirëmëngjesi Gjeneral.

23 PË. Faleminderit.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit të Seancës
25 të paraqesë në ekran dokumenti 1D14, SPOE0026181 [Sipas

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 6

1 përkthimit].

2 PY. Dëshmitar, dje po flisnit --

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka
4 transkript. Jo, tani doli. Atëherë thjesht nuk po lexoja
5 transkriptin, por tani u shfaq.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Në rregull. Atëherë besoj që po më
7 ndiqni tani.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

9 Z. HALLING: [Përkthim]

10 PY. Dje po flisnit që NATO-ja duhet të ishte e përgatitur për
11 çdo gjë që mund të ndodhte. NATO-ja duhet që të planifikonte
12 gjithashtu edhe përkundër sulmet e Serbisë në Kosovë, a është
13 e saktë kjo, Dëshmitar?

14 PË. Ma thoni edhe një herë, se nuk e kuptova. Cila ishte
15 pyetja?

16 PY. Pyetja ishte kjo: NATO-s i duhej që të planifikonte edhe
17 mundësinë e kundërsulmit serb.

18 PË. Jo, NATO-s nuk i duhej që të planifikonte këtë gjë dhe
19 nuk më ishte udhëzuar, nuk kisha marrë asnjë lloj udhëzimi për
20 një gjë të tillë. Megjithatë si komandant i përgjithshëm unë e
21 ndjeva që të informoja vartësit e mi që të përgatiteshim në
22 një situatë të pafate, për shembull, që do të mund të ndodhte
23 diçka, siç ishte rasti i asaj çfarë ndodhi në pistë në
24 Prishtinë.

25 PY. Në rregull atëherë. Te faqja që keni përpara ju lutem

1 lexojmë paragrafin e tretë.

2 Është ky shkëmbim me Gjeneralin Jackson. Ju thoni si më
3 poshtë:

4 "Kur të vijmë serbët unë do bëj ç'të jetë e mundur në
5 mënyrë të tillë që t'i jap fund luftës. Wes i tha VTC-së nga
6 Mons. Këtë herë ju duhet që 'të shkoni deri në fund' - me
7 gjasa deri në Beograd. Clark foli shumë lidhur me serbët që
8 mund të ktheheshin. Dhe ai tha që ne duhet që t'i mirëpresim
9 duhet 'të mirëpresim' një sulm serb".

10 Kjo thuhet në librin tuaj. A ju kujtohet kjo, Gjeneral?
11 PË. Nuk më kujtohet asnjë gjë e kësaj natyre. Por edhe në
12 qoftë se do më kujtohej, domethënë, sigurisht që përshkrimi
13 nuk është kështu. Jackson dhe unë e vlerësonim ndryshe
14 situatën dhe mbase do ishte me vlerë që ta shpjegoja përpara
15 Trupit Gjykues se cili ishte ky dallim midis nesh.

16 Jackson ishte i përfshirë si britanik, ishte i përfshirë
17 në situatën në Irlandë, ndërkohë që unë vetë e kisha parë me
18 sytë e mi nga afër situatën në Bosnjë. E dija për se çfarë
19 kishin mundësi dhe çfarë mund të të bënin serbët dhe cilat
20 mund të ishin pasojat. Kështu që, që prej fillimit ne kishim
21 perspektiva të ndryshme lidhur me situatën. Dhe mendoj që kjo
22 ishte edhe më e qartë pas asaj çfarë ndodhi në pistën ose në
23 aeroportin e Prishtinës.

24 Nuk e kam lexuar asnjëherë, në fakt, librin e Jackson.
25 Megjithatë mendoj që ky është një interpretim kreativ, krijues

1 do thosha, i asaj çfarë kam thënë unë.

2 PY. Kur juve ju është treguar kjo pjesë ju jeni përgjigjur si
3 më poshtë.

4 PË. Përgjigja juaj -- duhet të korrigjoj diçka: Mua nuk më
5 është treguar asnjëherë ky paragrafi i fundi. Atëherë,
6 përgjigja që unë kam dhënë kishte të bënte me paragrafin më
7 përpara.

8 Vetëm aty ku lexohet "që vetëm pas disa ditësh ..."

9 Dhe unë do thoja që ishte përgjegjësi e imja si komandant
10 i përgjithshëm që të isha i përgatitur për situata të
11 paparashikuara, për më të keqen e thënë ndryshe.

12 PY. Ajo çfarë keni thënë në seancën përgatitore, përkon me
13 atë çfarë thatë tani se që përgjegjësia juaj kryesore ishte që
14 në qoftë se serbët do të përpiqeshin që të sulmonin përsëri
15 Kosovën, ata do përgatiteshin ose do haseshin me një forcë të
16 përgatitur të NATO-s. Dhe ju e kuptuat që Milosheviqi ende
17 kishte synime të këqija, malije, dhe nuk mendonit që një
18 situatë e tillë ndoshta do të ishte e pamundur, apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. Çfarë thatë, ma thoni edhe një herë?

21 PË. Po, po kështu thashë.

22 PY. Dhe sa për të thënë, për ta përfunduar deri këtu, ju keni
23 thënë që Gjenerali Jackson ishte i përgatitur për të trajtuar
24 çdo gjë që mund të ndodhte.

25 Edhe juve ju ishte thënë në përgjigje, se në paragrafin e

1 tretë dhe siç thoni në këtë paragraf të tretë të kësaj situate
2 që "Kur serbët të vinin unë do bëj çdo gjë të mundesha që t'i
3 jepja fund luftës."

4 PË. Mund të ketë qenë diçka që e kam thënë, ndonjë gjë -- të
5 njëjtën pak a shumë në të njëjtën linjë. Megjithatë duhet të
6 them që në fillim fare që për komandën e NATO-s ishte që ne do
7 bënim ç'ishte e mundur që t'ia dilnim mbanë në operacionin
8 tonë. Që në fillim fare unë kam zbatuar ato mësimë që i kam
9 nxjerrë nga përvoja ime në Vietnam, nga përvoja ime ushtarake,
10 nga planifikimi në Haiti, nga operacionet në Bosnjë dhe nga
11 operacione të tjera të ngjashme.

12 PY. Pjesë e mandatit për këtë operacione ishte që të pengonit
13 luftimet e reja, apo jo?

14 PË. Ma thoni edhe një herë se nuk e kuptova pyetjen.

15 PY. Pra, pjesë e mandatit tuaj ishte që operacioni të dilte
16 me sukses?

17 PË. Për kë operacion e keni fjalën?

18 PY. E kam fjalën për operacionin që përshkruam në pyetjen e
19 mëparshme. Pra, për praninë ndërkombëtare të sigurisë në
20 Kosovë.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Të shohim dokumentin SPOE00405847
22 deri në 00405880, të transmetohet kjo në ekran.

23 PY. Gjeneral, ju besoj që keni thënë në shumë dëshmi dhe ju
24 kujtohet kjo, apo jo? Pra, keni dhënë deklarata të shumta
25 përpara Komitetit të Forcave të Armatosura të Senatit të

1 Shteteve të Bashkuara në vitin 1999 dhe në vitin 2000; a është
2 e saktë kjo?

3 PË. Kjo më kujtohet.

4 PY. Siç mund ta shikoni, dhe për këtë më tepër do doja që të
5 shikonim faqen SPOE00405851. Kjo është njëra prej deklaratave
6 që keni dhënë më 1 korrik 1999.

7 Pyetja që ju bëhet juve në mes të faqes është që për sa
8 kohë do të zgjasë forca ndërkombëtare në Kosovë dhe ju keni
9 dhënë këtë përgjigje:

10 "Z. Kryetar, nuk mendoj që në këtë kohë është e mundur që
11 të jap një përgjigje përfundimtare për këtë pyetje. Më lejoni
12 t'ju përshkruaj disa prej shqetësimeve të cilat lidhen me këtë
13 temë. Së pari, nuk ka akoma një marrëveshje paqeje në Kosovë.
14 Ne jemi në një situatë armëpushimi."

15 Pra, kur ju jeni futur në Kosovë nuk kishte situatë
16 zgjidhur, domethënë nuk është se kishte ndonjë marrëveshje, po
17 ishte thjesht një situatë ku ishte armëpushim, apo jo?

18 PË. Kështu e shihja unë; kështu e kam përshkruar situatën.

19 PY. Dhe nuk ka pasur një marrëveshje paqeje deri nga mesi i
20 shtatorit të '99, apo jo?

21 PË. Po, teknikisht kjo është e saktë. Dhe në fakt deri në
22 2008-n situata ka qenë e ngjashme deri atëherë kur Kosova
23 arriti pavarësinë e saj.

24 PY. Në postin tuja, në pozicionin që kishit në SACEUR, ju
25 vazhdonit të ishit i shqetësuar që gjeneralët serbë kërcënonin

1 që të shkonin prapë përsëri në Kosovë, të ktheheshin në Kosovë
2 edhe pas shtatorit të '99-s, a është e saktë kjo?

3 PË. Unë vazhdoja të isha i shqetësuar për mundësinë e
4 agresionit serb, jo vetëm në Kosovë, por në të gjithë rajonin
5 dhe kishte një arsye për këtë.

6 PY. Kur po flisnit dje për gjeneralët serbë që jepnin
7 informata të rreme që nuk donin që ta pranonin humbjen, ju
8 ende ishit të shqetësuar që ata mundej që të ktheheshin prapë
9 në Kosovë, apo jo?

10 PË. Unë do ta formuloja kështu: Në qoftë se ti do më pyesje
11 mua që a do ktheheshin ata në Kosovë, unë do thosha jo. Por në
12 qoftë se do më pyesnit se çfarë përgjegjësie kisha unë, unë do
13 t'ju përgjigjesha që përgjegjësia ime ishte që të sigurohesha
14 që ata nuk do të vinin më në Kosovë. Dhe në kuadër të
15 përgjegjësisë të mia ishte e rëndësishme që unë të kuptoja të
16 gjitha rreziqet e mundshme që ekzistonin dhe të kisha një lloj
17 plani dhe të ndaja shqetësimet e mia me komandantë që punonin
18 për mua, përshirë këtu edhe Mike Jackson.

19 PY. Nuk ju bëra këtë pyetje. Ju thashë ekzistonte një
20 shqetësim real i juaji që serbët mund të ktheheshin përsëri.

21 PË. E di që nuk më bëtë këtë pyetje, por unë i dhashë
22 shpjegimet për të kuptuar se në çfarë drejtimi po shkon kjo
23 bisedë. Ajo çfarë po përpiqem unë që të shpjegoj është që pse
24 i kam bërë deklaratat që kam bërë, jo se vazhdonte të kishte
25 gjendje lufte, por për shkak të mungesës së marrëveshjes dhe

1 për shkak të informacionit të vazhdueshëm që unë merrja lidhur
2 me deklaratat e serbëve, inatin e serbëve dhe fakti që
3 Milosheviqi ishte një personazh i zgjuar dhe dinak që kishte
4 mënyra të shumta për të funksionuar.

5 Kështu që, në qoftë se ti më kërkon që unë të bëj një
6 gjykim 25 vite më pas, në qoftë se ka pas ndonjë lloj mundësie
7 që Serbia të kthehej përsëri në Serbi [Sipas përkthimit] unë
8 mund të them që sigurisht nuk kishte aq shanse që të kthehesh,
9 domethënë që Serbia të ktheheshe në Kosovë. Dhe kur Mike
10 Jackson ka shkruar librin e vet 10 ose 15 vite më pas,
11 sigurisht të gjithë e dinin që Serbia nuk u kthye më në
12 Kosovë. Por ishte pjesë e përgjegjësive të mia si gjeneral që
13 të merrja të gjitha përgjegjësitë dhe të bëja të gjitha
14 planifikimet e nevojshme në mënyrë të tillë që të sigurohesha
15 që Serbia nuk do ktheheshe më. Se në qoftë se do kisha vepruar
16 ndryshe atëherë kjo donte thoshte që nuk po ushtroja detyrat e
17 mia siç duhet.

18 PY. E kuptoj, e kuptoj atë çfarë duhej që të projektonit në
19 terren.

20 PË. Në rregull.

21 PY. Por pyetja ime është kjo, është më personale: Ju
22 personalisht a ishit të shqetësuar që serbët mund të
23 ktheheshin?

24 PË. Besoj që do kem qenë pak i shqetësuar se përndryshe nuk
25 do kisha thënë ndonjë gjë, por nga ana tjetër dua që të

1 kuptoni që kjo ishte përgjegjësia e imja. Kur përfundoi ky
2 konflikt, konflikti përfundoi me orvatjet e Rusisë për të
3 diskretituar dhe për të shkatërruar operacionin e NATO-s. Ne
4 asnjëherë s'e kemi zbuluar deri në fund të vërtetën pas kësaj.
5 Ne e dinim që koloneli, Gjeneral Koloneli Ivanov që ishte një
6 prej udhëheqësve të asaj kohe është dekoruar nga Kremlini për
7 këtë operacion, dhe ky operacion është konsideruar prej tyre
8 si një sukses i jashtëzakonshëm. Por në fakt ajo çfarë ndodhi,
9 dhe falë Mike Jackson që ishte në terren është që rusët ishin
10 disi të kapur mat në fushën ajrore në pistë në aeroport.
11 Megjithatë më duhet të them që në mëngjesin e 11 qershorit, ka
12 qenë ditë e premtë, ne filluam që të merrnim informacione që
13 nuk bëhet fjalë vetëm thjesht për një batalion, por bëhej
14 fjalë për një plan të tërë të stisur të hollësishëm pas këtij
15 operacioni. Dhe ideja ishte që divizioni ajror rus ishte i
16 përgatitur që të futej në Kosovë. Kështu që konteksti ishte
17 shumë herë më i komplikuar se sa ç'mund të krijohej në pamje
18 të parë.

19 Pastaj kemi incidentin e 11 dhjetorit dhe me ç'më
20 kujtohet, Sekretarja Albright, Sekretari Cohen ishin në
21 Finlandë për ca kohë në mënyrë që të gjenin një zgjidhje me
22 rusët. Më kujtohet që kam qenë për shumë kohë, kam shpenzuar
23 shumë kohë në telefon me Sekretarin Cohen duke i shpjeguar që
24 rusët nuk janë aty si aktor legjitim dhe rusët janë aty me
25 planet e tyre dhe ju lutem mos i cenoni operacionet e NATO-s

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 14

1 dhe planet që ne i kemi parashikuar për sa i takon situatës
2 konkrete.

3 Nuk më kujtohen hollësitë e këtyre bisedave. Megjithatë
4 më kujtohet që kemi pasur shumë thirrje telefonike dhe
5 shkëmbime informacionesh.

6 Megjithatë e di që ka pasur po ashtu pakënaqësi të shumta
7 me lindjen e mëtejshme, me rezultatin e operacioneve që
8 gjithashtu është shoqëruar edhe nga veprimet e Vladimir --
9 Primakov dhe Vladimir Putin jashtë Rusisë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po i
11 përgjigjeni një pyetje që nuk iu bë fare.

12 DËSHMITARI: [Përkthim] Është e vërtetë, por është e
13 rëndësishme që unë t'ju jap juve kontekstin e përgjithshëm; në
14 çfarë konteksti më është dashur mua që të funksionoj si
15 komandant strategjik, si person që isha në terren për t'i
16 gjetur zgjidhje situatës.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjeneral,
18 është e rëndësishme që të dëgjoni pyetjen dhe t'i përgjigjeni
19 pyetjes, mos të na jepni kontekstin më të gjerë.

20 DËSHMITARI: [Përkthim] Në rregull.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Atëherë dëshiroj që të shohim në
22 ekran dokumentin DHT1029 deri në DHT10336.

23 PY. Besoj se kjo është në përputhje me atë çfarë po na thonit
24 në përgjigjen e pyetjes së fundit, megjithatë dua që ta
25 sqarojmë për procesverbal.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Po pres Sekretarin që ta paraqesë
2 këtë dokument në ekran.

3 PY. Siç mund ta shikoni, kjo është një tjetër seancë përpara
4 senatit të Shteteve të Bashkuara, Komiteti i Shërbimeve të
5 Armatosura.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Kjo është faqja e parë e
7 dokumentit. Ndërkohë do kërkoja që të kalonim në një tjetër
8 faqe të këtij dokumenti DHT10335.

9 PY. Këtu bëhet fjalë për shkëmbimet për helikopterët Apache
10 të dislokuara, pra, ju thoni në një pjesë:

11 "Po zotëri, kjo është e saktë. Dhe sigurisht në atë kohë
12 ne nuk kishim ide fare se sa do zgjaste kjo. Megjithatë në
13 retrospektivë sikurse e shikoj unë situatën gjëja tjetër është
14 që jam ende i shqetësuar për forcat serbe. Ne ende kemi
15 gjeneralë serbë të cilët kërcënojnë se do të kthehen përsëri
16 në Kosovë."

17 Kjo është pjesë e dëshmisë tuaj, apo jo, Dëshmitar? Është
18 dëshmi të cilën ju e keni dhënë në shkurt të viti 2000.

19 PË. Po.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne kërkojmë
21 që të pranohen faqet e treguara për seancat përpara Senatit të
22 Shteteve të Bashkuara të cilat sapo i përdorëm me dëshmitarin,
23 dhe e kam fjalën konkretisht për deklaratën e dhënë më 1
24 korrik 1999. Do ishte faqja e parë që është SPOE00405847 deri
25 në SPOE00405851, dhe më pas seancën që është e pasqyruar

1 aktualisht në ekran që i takon që është dokumenti DHT10293 dhe
2 më pas DHT10335.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka
4 kundërshtime?

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do ju
6 kërkonim që të na linit kohë deri në orën 11.30 pas pushimit
7 të kafes, sepse duhet të bëj pak kërkim për të parë në qoftë
8 se një seancë përpara Senatit konsiderohet si një dokument i
9 cili mund të pranohet në proces gjyqësor për qëllime të
10 rregullës 153 deri 155.

11 Z. HALLING: [Përkthim] E kemi bërë ne këtë kërkim, kështu
12 që nuk ka asnjë pengesë.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, nuk dua të dëgjoj
14 opinionin e Prokurorit, thjesht dua të bëj punën time.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
16 Tani, a keni pyetje të tjera lidhur me këtë temë?

17 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi pyetje të tjera sa i
18 takon seancave përpara Senatit, por argumenti ynë do të ishte
19 i ngjashëm me argumentin e një seance parlamentare. Dhe në të
20 shkuarën, ju, dëshmitë e dhëna përpara seancave parlamentare i
21 keni pranuar si prova gjyqësore. Mund t'ju jap, për shembull,
22 rastin e P942 që përsëri është marrë në të njëjtin kontekst.
23 Kështu që ne mendojmë që duhet të jetë dhe një provë e
24 pranueshme.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 17

1 Atëherë do i japim avokatit mundësinë që të shikojë dokumentin
2 përpara se të marrin vendimin.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Atëherë do i caktojmë një numër
4 provizor, apo jo?

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, kështu.

6 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
7 dokumenti SPOE00405847 deri në 00405880 dhe më konkretisht
8 faqet SPOE00405847 dhe faqja 00405851 do marrë numrin e provës
9 provizore P04515.

10 Ndërkohë dokumenti me numër ERN DHT10293 deri në DHT10336
11 dhe konkretisht faqet DHT10293 dhe faqja 10335 do marrin
12 numrin e provës provizore P04516.

13 Sa për ta sqaruar, klasifikimi për P0515 [Sipas
14 përkthimit], aktualisht është i klasifikuar si konfidencial.
15 Dhe dokumenti me numër provizor prove P04516 aktualisht është
16 i klasifikuar si publik

17 Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Të dy mund të jenë publike.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të vendos
20 për këtë pasi të kemi vendosur për pranueshmërinë e tyre, apo
21 jo?

22 Z. HALLING: [Përkthim] Mund të heqim dokumentin nga
23 ekrani.

24 PY. Kalojmë në një temë tjetër, Gjeneral. Ju thatë se e keni
25 konsideruar dhunën në verë dhe vjeshtë të '99-s si një

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 18

1 konflikt shumë personal mes fqinjëve për të cilën udhëheqja e
2 UÇK-së nuk ishte përgjegjëse, është kështu? Keni thënë këtë në
3 deklaratën tuaj?

4 PË. Po.

5 PY. Ju tregua dje një intervistë me *PBS News Hour*, thirrjet e
6 UÇK-së për një shoqëri shumë etnike që ju e keni vlerësuar si
7 thirrje të singertë. E kam fjalën, që të fillojmë me këtë, ju
8 po flisnit për mungesën e provave të spastrimit etnik nga ana
9 e UÇK-së, është e saktë?

10 PË. E saktë.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Shfaqim në ekran tani dokumentin
12 provën materiale 1D387. Është deklaratë nga gazeta që quhet
13 Shekulli. Nuk mendoj që mbrojtja tha ashtu. Ka treguar këtë,
14 por ka një citim të tuajin në të për të cilin dua t'ju bëj
15 pyetje. Dëshmitarët e tjetër janë pyetur lidhur me këtë. Ju po
16 flisni --

17 Më 14 gusht 1999 dhe në pjesën që na intereson neve
18 thuhet:

19 "Clark tha se udhëheqësit e UÇK-së kanë mbështetur
20 thirrjet e tyre që serbët të qëndrojnë në rajon. 'Nuk do të
21 drejtoj gishtin tek UÇK-ja. Udhëheqësi i tyre ka qenë shumë
22 bashkëpunues me ne në nivele të larta', iu tha gjenerali
23 amerikan gazetarëve në shtabin, në selinë e KFOR-it. Disa
24 zyrtarë ndërkombëtarë thanë se UÇK-ja ishte në origjinë të
25 këtyre sulmeve kundër serbëve dhe se kanë dëbuar 170.000 serbë

1 nga Kosova."

2 Gjeneral, deklarata juaj që keni dhënë, siç raportohet
3 këtu, edhe këtu bëhet fjalë për mungesën e provave të
4 spastrimit etnik nga ana e UÇK-së, a është kështu?

5 PË. Unë nuk kam prova apo dëshmi se UÇK-ja ishte prapa kësaj
6 dhe kam indikacione që provojnë të kundërtën.

7 PY. Në rregull. Por kur thoni "kjo" në përgjigjen tuaj, e
8 keni fjalën për spastrimin etnik?

9 PË. Po i referohem deklaratës, ku përmendet rreth 170.000
10 serbë pretendohet të jenë dëbuar nga Kosova.

11 PY. Në, pra, komentet tuaja lidhur me udhëheqjen e UÇK-së,
12 kanë të bëjnë me këto 170.000 serbë --

13 PË. E saktë.

14 PY. -- që u larguan nga Kosova. Pra, pyetja ime është,
15 pyetjet që dua t'ju bëj nuk kanë të bëjnë me dhunën në
16 kuptimin e gjerë dhe të shpërndarë dhe djegiet e shtëpive e
17 kështu me radhë në verë të '99-s në Kosovë. Dua të
18 përqendrohem vetëm me mënyrën se si UÇK-ja ka shënjestruar për
19 arrest -- ka arrestime dhe mbajtje në ndalim të personave të
20 caktuar.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Artikulli tani mund të hiqet nga
22 ekrani.

23 PY. Gjeneral, ju përmendët se si rrallëherë keni marrë pjesë
24 në takimet e Këshillit të Përbashkët për Zbatim, a e dini nëse
25 kishte shqetësime që janë apo a janë diskutuar shqetësime në

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 20

- 1 këto mbledhje lidhur me arrestimet e bëra dhe mbajtje në
2 ndalim të bëra nga UÇK-ja?
- 3 PË. Nuk më kujtohet.
- 4 PY. A e dini nëse UÇK-ja ka ardhur në KFOR për të raportuar
5 ndonjë krim të kryer nga pjesëtarët e saj, për të bërë hetime?
- 6 PË. Nuk më kujtohet.
- 7 PY. Të paktën derisa aparati i policisë së UNMIK-ut u vendos
8 aty, KFOR-i ishte i përgatitur të bënte hetimet, për të hetuar
9 krime të tillë, a është kështu?
- 10 PË. Kështu.
- 11 PY. Tani do të kaloj te vizita jua në gusht 1999 në Kosovë.
- 12 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe për këtë, të nderuar Gjykatës,
13 do të doja të kalonim në seancë private pasi disa dokumente
14 janë të përfshirë në nga kufizimi, mbulohen nga kufizimet e
15 rregullës 107.
- 16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në
17 seancë private.
- 18 [Seancë private]
- 19 [Seancë private teksti i fshirë]
- 20
- 21
- 22
- 23
- 24
- 25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 21

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 22

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 23

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 24

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 26

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 27

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 28

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 29

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 30

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 31

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 32

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 33

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 34

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13 [Seancë e hapur]

14 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

16 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, po shosh orën.

17 Ndoshta është momenti që të bëjmë pushimin 10-minutësh.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë 10

19 minuta pushim.

20 DËSHMITARI: [Përkthim] Në rregull.

21 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Seanca

23 ndërpritet për 10 minuta.

24 --- Seanca ndërpritet në orën 09.59

25 --- Seanca rifillon në orën 10.10

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 35

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
2 sillni dëshmitarin.

3 [Dëshmitari vijon dëshminë]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
5 Do të vazhdojmë.

6 Z. Halling, fjala është ende për ju.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

8 PY. Mirëmëngjesi sërish.

9 PË. Mirëmëngjesi.

10 PY. Tani dua të flasim për diçka që e keni diskutuar disa
11 herë gjatë dëshmisë suaj, promovimi i shoqërisë multietnike në
12 Kosovë dhe është një fushë konkrete për të cilën dua t'ju bëj
13 pyetje. Ku është Lugina e Preshevës?

14 PË. Lugina e Preshevës është në pjesën e ish-Jugosllavisë në
15 Serbi.

16 PY. Kjo ka qenë një zonë delikate pas luftës, apo jo?

17 PË. Po.

18 PY. Pse?

19 PË. Ka pasur një popullsi të konsiderueshme shqiptarësh në
20 këtë zonë që ndodhet në Serbi.

21 PY. Shqiptarët e Kosovës e quajnë Preshevën territor shqiptar
22 ku shqiptarët kanë të drejtën të jetojnë, sigurisht deklarata
23 të tilla i rrezikonin marrëdhëniet mes serbëve dhe shqiptarëve
24 në Kosovë?

25 PË. Po.

1 PY. Po ashtu shqiptarët e Kosovës shpreheshin se dhuna në
2 Luginën e Preshevës nuk duhet toleruar dhe ishte e rrezikshme
3 asokohe sepse kjo zonë ishte pjesë e Serbisë, kështu?

4 PË. Ma bëni dhe një herë pyetjen, ju lutem?

5 PË. Pra, edhe shqiptarët e Kosovës bënë thirrje se nuk duhej
6 toleruar dhuna ë Luginën e Preshevës, po kjo ishte e
7 rrezikshme të thuhej asokohe sepse kjo zonë është në Serbi?

8 PË. Nuk jam i sigurtë a ishte e rrezikshme, ata kishin të
9 drejtën e tyre të shpreheshin, të flisnin për ndikimin e
10 masave serbe ndaj shqiptarëve në një territor fqinjë.

11 Z. HALLING: [Përkthim] I lutem Sekretarit të seancës të
12 nxjerrë në ekran materialin SPOE40015904 deri në SPOE40016230-
13 ET REV-Pjesërisht-Combined.

14 Dhe të njëjtën ERN e ka dhe një material tjetër. Një prej
15 këtyre materialeve është një përmbledhje dhe ka marrë numrin
16 P4497 dhe numrin tjetër është një version me 94 faqe i
17 materialit të përkthyer. Ne duam të shikojmë materialin e
18 dytë. Edhe një herë materiali me 94 faqe ka numrin
19 SPOE40016149.

20 PY. Gjeneral, ndërkohë që presim materialin, dëshiroj t'ju
21 pyes, a njihni një person me emrin Klaus Reinhardt?

22 PË. Po.

23 PY. Kush ishte?

24 PË. Ishte personi që zëvendësoi Mike Jackson në KFOR.

25 PY. Ju keni punuar me të në cilësinë e tij si komandant i

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 37

1 KFOR-it, apo jo?

2 PË. Po.

3 PY. Ai ka mbajtur shënime që ne i kemi përkthyer dhe ka një
4 shënim i 10 marsit 2000 ku përmendeni dhe ju dhe dua t'ju
5 tregoj dhe më pas t'ju bëj një pyetje. Dhe presim që të
6 shfaqet në ekran.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Pra edhe një herë për Sekretarin e
8 seancës bëhet fjalë për faqen SPOE0040016149. Pak më lartë.
9 Pra edhe një herë pak më lart. Bëhet fjalë për materialin që
10 mban numrin 6149. Ky është. Faleminderit.

11 PY. Ky është shënimi përkatës. Gjeneral, përpara se t'ua
12 lexoj, a është shumë i vogël për ju?

13 PË. Jo, mund ta lexoj.

14 PY. Gjenerali Reinhardt flet me Hashim Thaçin në një
15 konferencë për Luginën e Preshevës dhe thotë si në vijim. Ai
16 fillon:

17 "Mesazhi im është i shkurtër. 'Jam shumë i shqetësuar për
18 ngjarjet e fundit në Luginën e Preshevës. Situata në kufi mes
19 Kosovës dhe Luginës së Preshevës mund të përshkallëzojë shumë
20 shpejt dhe të krijojë një konflikt që do të ndikojë në të
21 gjithë rajonin. Kjo nuk është në interesin e popullatës, të
22 KFOR-it apo të komunitetit ndërkombëtar ... prandaj ne e
23 dënojmë përdorimin e dhunës në këtë zonë.'"

24 Kalojmë në faqen tjetër që të shohim Hashim Thaçin çfarë
25 ka thënë në të njëjtën konferencë për shtyp:

1 "Thaçi ka një pikëpamje krejt të ndryshme. Ai akuzon
2 palën serbe se ka rifilluar gjenocidin dhe dëbimin e
3 personave. Ai shpjegon situatën e refugjatëve që ka parë dhe
4 pretendon se atyre u është dashur të kalojnë në këmbë përmes
5 bjeshkëve me sendet e tyre të fundit. Mbase ai ka qenë në një
6 film tjetër nga ai i imi. Ai flet më pas për vuajtjet e
7 shqiptarëve që janë persekutuar, që nuk janë më të gatshëm t'i
8 pranojnë këto gjëra. Dhe nuk tha asnjë fjalë që ai distancohet
9 nga UÇMBP-ja, nuk tha asnjë fjalë për sigurinë, por
10 përkundrazi tha të kundërtën, dha deklaratat të rreme dhe bëri
11 propagandë. Unë jam shumë i zemëruar që nuk mund të ndërhyj
12 tani përpara kamerave që po na xhirojnë. Sapo të dalë nga
13 dhoma, unë e ballafaqoj Thaçin. Ai është krejt i befasuar. Më
14 le fare pa fjalë dhe unë i thashë që e tradhtove besimin tim.
15 Ai pretendon se foli si një politikan i shqiptarëve të
16 Kosovës. Dhe i thashë që nuk dua të bëj më asnjë konferencë të
17 ngjashme me ju, të tillë dhe do ta kufizoj deri në minimum
18 bashkëpunimin me ju. Kjo nuk duket se e bezdis Thaçin. Ai i ka
19 bërë pikat e veta 'kombëtare' dhe ai pret të sigurojë
20 miratimin e popullatës shqiptare.

21 "Më pas marr SACEUR dhe i thashë që më kanë zhgënjyer
22 thellësisht, Thaçi më ka zhgënjyer thellësisht dhe nuk do dalë
23 më asnjëherë me të përpara mikrofonave, sepse ky person nuk
24 duhet besuar. Gjenerali Clark po ashtu ishte i inatosur, pasi
25 Thaçi atij i kishte premtuar diçka krejt të ndryshme."

1 Gjeneral, ju kujtohet kjo ngjarje që ka përshkruar

2 Gjenerali Reinhardt?

3 PË. Po, më kujtohet kjo ngjarje.

4 PY. Përshkrimi i Gjeneralit Reinhardt, mesa ju kujtohet ju, a
5 është i saktë?

6 PË. Unë nuk kam qenë personalisht atje dhe nuk e di çfarë ka
7 ndodhur. Por unë e di që ishte një situatë, po bëhej një kalim
8 i UÇK-së nga një organizatë ushtarake dhe rezistence në një
9 person që kërkonte të siguronte të ardhmen politike për vete
10 dhe për vendin e tij të Kosovës.

11 Ne ishim me fat, nëse më lejoni ta shpjegoj, që kishim
12 Ibrahim Rugovën që priste dhe ishte një lëvizje politike që
13 ishte e shtrirë në të gjithë Kosovën në fakt kur kemi hyrë ne
14 dhe kjo lëvizje politike u rishfaq me Partinë Liberal
15 Demokratike të Kosovës dhe me Ibrahim Rugovën me sa më
16 kujtohet. Pra, Thaçi ka pasur pikëpamje të tjera dhe ka
17 ndjekur një kauzë tjetër.

18 Por unë kam lexuar që ka pasur dhunë ndaj shqiptarëve në
19 Luginën e Preshevës, këtë më kujtohet që e kam lexuar.

20 PY. Faleminderit. Kërkojmë të pranohet kjo pjesë e shënimeve
21 të Gjeneralit Reinhardt dhe do të propozonim që t'i
22 bashkëngjitet provës P4497.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

24 Z. HALLING: [Përkthim] Pra, vetëm këto dy faqet kërkojmë
25 që të pranohen me numër SPOE40016149 deri në SPOE40016150.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] E kundërshtojmë relevancën goftë
2 për përmbajtjen dhe për periudhën kohore të këtij shënimi.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Është diskutuar Lugina e Preshevës
4 gjatë e gjerë me Dëshmitarin 04868, veçanërisht fjalimi që ka
5 mbajtur z. Thaçi pas periudhës kohore për të cilën ngrihen
6 akuza dhe për të cilat janë aspekte që janë trajtuara dhe në
7 shënimet e Gjeneralit Reinhardt. Në rastin e këtij dëshmitari
8 është vlerësuar se kjo ishte relevante ndonëse periudha për të
9 cilën flitet është pas periudhës së aktakuzës.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'i
11 pranojmë këto dy faqe.

12 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Këto dy faqe në fakt do
13 t'i bashkëngjiten provës P04497. Faleminderit.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit. Dhe mund të hiqni
15 dokumentin nga ekrani.

16 PY. Gjeneral, të flasim pak për takimet që keni pasur me UÇK-
17 në, por fillimisht të flasim në vija të përgjithshme lidhur me
18 informacionin që kishit marrë prej tyre.

19 Nga fillimi i 1998 dhe deri në fundin e fushatës ajrore,
20 sa herë keni shkuar në Kosovë?

21 PË. Do duhet të shikoja shënimet e mia për t'u përgjigjur.

22 PY. Nuk përmenden fare këto vizita në librin tuaj. Pra, a
23 keni shkuar në Kosovë gjatë kësaj periudhe kohore, a ju
24 kujtohet?

25 PË. Para fushatës ajrore nuk kam qenë në Kosovë, nuk e kam

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 41

1 vizituar Kosovën. Ka qenë pjesë e Serbisë. Nuk mendoja se do
2 më mirëprisnin atje. Kisha folur me gjeneralët serbë, sikurse
3 ua thashë në fund të tetorit të 1998. Në 1999, filluam
4 fushatën ajrore, kështu që sigurisht që nuk do shkoja atje mes
5 Masakrës së Reçakut dhe fundit të fushatës ajrore. Nuk e di sa
6 herë e kam vizituar Kosovën pas fushatës ajrore.

7 PY. Në fakt ju përgjigjët pyetjes time. A është e vërtetë që
8 veprimet e para të UÇK-së prej komunitetit ndërkombëtar
9 konsideroheshin si veprime terroriste?

10 PË. Ka pasur diskutime lidhur me këtë pikë. Më kujtohet që
11 Ambasadori Gelbard e ka thirrur familjen Jashari familje
12 terroristësh, por për këtë u qortua nga udhëheqja amerikane
13 dhe deklarata e tij u tërhoq dhe u korrigjua.

14 PY. Në rregull.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Shohim materialin SPOE00406262
16 deri në 00406262.

17 PY. Gjenerali Clark, kjo është një intervistë që mendohet që
18 e keni dhënë ju në 9 mars 1998. Pra, pas vrasjes së Jasharëve.
19 Thoni si në vijim:

20 “E dënojmë dhunën kundër personave që kanë shprehur
21 orientimet e tyre politike në mënyrë jo të dhunshme. Po ashtu
22 dënojmë metodat terroriste që po përdoren për të realizuar
23 objektiva të caktuara’ ...”

24 Pra dhe ju vetë jeni një prej personave që i keni lidhur
25 veprimet që po ndodhnin asokohe në Kosovë me veprime

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 42

1 terroriste, apo jo?

2 PË. Metoda terroriste kam dënuar unë.

3 PY. NATO nuk ishte në gjendje të komunikonte drejtpërdrejt
4 me UÇK-në gjatë fushatës ajrore sepse ata etiketoheshin si
5 terroristë, apo jo?

6 PË. Nuk jam i sigurtë nëse kjo është e vërtetë.

7 PY. Do t'ju tregoj diçka.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Por përpara se të tregoj
9 materialin, do kërkoja që të pranohet materiali që sapo pamë
10 në ekran, bëhet fjalë për materialin SPOE00406262 deri në
11 SPOE00406262.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtime?

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
15 Materiali SPOE00406262-00406262 pranohet.

16 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Materiali do të marrë
17 numrin P04517 dhe klasifikimin e ka konfidencial.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Mund të jetë dokument publik. A
19 dëshironi ta riklasifikoni P4517 tani apo më vonë?

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani do ta
21 riklasifikojmë.

22 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull. Atëherë
23 prova materiale P4517 do të riklasifikohet si provë publike.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një çast, ju
25 lutem.

1 [Trupi Gjykses dhe Sekretari i Gjykatës
2 këshillohen]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

5 PY. Dëshmitar, në lidhje me përgjigjen e fundit që dhatë ju
6 përmendët Klaus Naumann dhe, në faqen 23 të transkriptit të
7 ditës së djeshme.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

9 [Trupi Gjykses dhe Sekretari i Gjykatës
10 këshillohen]

11 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

12 I lutem Sekretarit të seancës të nxjerrë në ekran
13 materialin SPOE00406441 deri në 00406504.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shumë prej
15 nesh kanë probleme me transkriptin. Mua nuk më punon
16 transkripti. Nuk punon transkripti.

17 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

18 Z. HALLING: [Përkthim]

19 PY. Ju kërkoj ndjesë, Gjeneral. Presim që të dali materiali
20 në ekran, ju lutem.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Po i jap dhe një herë numrin
22 Sekretarit të seancës. Është SPOE00406441 deri në 00406504.

23 PY. Kjo është dëshmia e Klaus Naumann nga gjykimi i
24 Milutinovic përpara TPNJ-së, ka një fragment që dua ta
25 trajtojmë së bashku.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Shkojmë në faqen SPOE00406463.

2 PY. Gjeneral, përpara se ta lexoj citimin desha t'ju pyes
3 çfarë roli ka pasur Klaus Naumann në NATO deri në 1999?

4 PË. Ka qenë zëvendëskryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Shkojmë në fundin e faqes, në fakt
6 është faqja tjetër, një faqe më lart. Shkojmë më poshtë.

7 PY. Gjykatësi Bonomy në fund fare flet për shtrirjen e
8 kërcënimeve terroriste atje.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër tani.

10 PY. Pra, gjykatësi Bonomy i bën këtë pyetje:

11 "A ka pasur ndonjë planifikim të NATO-s sesi do të
12 trajtohej UÇK-ja në një mjedis që po përpigëni që të krijoni
13 ju, mjedisi i ndërmjetësimit?

14 Edhe Klaus është përgjigjur si në vijim.

15 Ai thotë:

16 "Kjo gjë, i nderuar Gjykatës, ka qenë thembra jonë e
17 Akilit nëse më lejoni të shprehem kështu. Po e them hapur këtë
18 dhe troç dhe shpresoj të jem i qartë në mënyrë të
19 drejtpërdrejtë. Bëmë një gabim. Kur them "ne", flasim
20 udhëheqja politike e NATO-s në pranverën e 1998-s kur e
21 thirrëm UÇK-në grup terroristësh. Kjo gjendet në dokumente të
22 NATO-s që janë diskutuar në takimet e ministrave të jashtëm
23 edhe pasi deklaruar që UÇK-ja ishte grup terroristësh në
24 mënyrë të pashmangshme paralizuar instrumentet tona për të
25 bashkëpunuar me ta, sepse në NATO nuk ka pasur asnjë shpresë,

1 nuk kishte asnjë provë për të kontaktuar drejtpërdrejt
2 terroristët. Pra, duhej një vendim, duhej konsensusi nga 16
3 kombe. Megjithëse këto kombe kishin një problem terroristësh
4 në duart e tyre, ata refuzuan në mënyrë kategorike që ne të
5 bashkëpunonim me terroristët. Dhe pikërisht kjo ishte thembra
6 e Akilit. Nuk kishim asnjë instrument për të komunikuar me
7 UÇK-në".

8 Pra, Klaus Naumann përshkruan kompleksitetet që kishte
9 bashkëpunimi me UÇK-në, apo jo, apo komunikimi me UÇK-në?
10 PË. Po, këtë po përshkruan.

11 PY. Mike Durkee ka qenë një prej këshilltarëve tuaj gjatë
12 luftës?

13 PË. Po.

14 PY. Javën e shkuar ai ka qenë këtu dhe ka folur për takimin
15 që keni pasur në marsin e 1999 ku e keni diskutuar në
16 paragrafin 22 të deklaratës tuaj, bëhet fjalë për takimin me
17 delegacionin e UÇK-së.

18 Thotë që ka pasur protokoll sesi duhet të trajtoheshin
19 vizitorët e huaj në selinë e NATO-s, ishte një lloj ceremonie
20 që ndiqej, apo jo? Kjo ishte tipike, apo jo?

21 PË. Po.

22 PY. Ai thotë që jeni takuar me UÇK-në në mars të 1999-s në
23 një fushë ajrore jashtë selisë së NATO-s. Edhe ai tha që ju
24 deshët që t'i njihnit ata dhe nuk deshët që t'i legjitimonit
25 domosdoshmërisht, apo jo?

1 PË. Siç e kujtoj unë, nuk ka qenë kjo arsyeja për t'u takuar
2 në fushën ajrore. Kjo ka qenë hera e vetme që unë mund të
3 organizoja një takim me ta për shkak të kalendarit tim dhe për
4 shkak të disponueshmërisë së Thaçit, mua më duhej të fluturoja
5 atë ditë. Dhe Mike Durkee mbase mund ta ketë parë si lëvizje
6 të mundshme prej anës time për të më mbrojtur mua nga ndonjë
7 kritikë e mundshme e NATO-s. Por unë, në fakt, në të vërtetë
8 unë thjesht desha t'i takoja ata dhe pista ajrore ishte i
9 vetmi vend ku mund të takohesha me ta për shkak të
10 disponueshmërisë sonë.

11 PY. E kuptoj. Ju keni folur dhe me Mbrojtjen e Thaçit për
12 letrën e Barbara Larkin. Etiketimi si terrorist për UÇK-në në
13 fakt fillimisht kishte dalë nga komuniteti ndërkombëtar sepse
14 nuk deshën t'u jepnin armë, apo jo?

15 PË. Unë nuk jam i sigurtë çfarë ka ndodhur. Dhe unë nuk e di
16 se si janë armatosur ata.

17 PY. A nuk është e vërtetë që të armatosje UÇK-në do të ishte
18 në kundërshtim me kushtet e Rambujesë, në kundërshtim me atë
19 që kishte rënë dakord komuniteti ndërkombëtar dhe ju
20 personalisht?

21 PË. UÇK-ja e nënshkroi Marrëveshjen e Rambujesë, por besoj se
22 ka pasur -- janë bërë dhe rekrutime, kanë siguruar dhe
23 armatime pasi është nënshkruar Marrëveshja e Rambujesë sepse
24 pala serbe refuzoi ta nënshkruante edhe filloi konfliktin. Unë
25 nuk kam marrë ndonjëherë detaje të asaj që ka ndodhur, po

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 47

1 është përshtypja ime që ata e kanë marrë një mbështetje prej
2 diku.

3 PY. Tani do shohim së bashku një intervistë që keni dhënë në
4 gusht të 1999.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Për referencë bëhet fjalë për
6 dokumentin SPOE00397623 deri në 00397624. Faqja e parë.

7 PY. Është diçka që raportohet nga Cleveland *Plain Dealer* dhe
8 është një intervistë që e keni dhënë më datën 15 gusht. Do
9 t'jua tregoj këtë intervistë për t'ju treguar nivelin e
10 komunikimit të drejtpërdrejtë që keni pasur ju aso kohe me
11 UÇK-në.

12 Z. HALLING: [Përkthim] Shohim pak më poshtë në tekst.

13 PY. Kjo ka ndodhur më datë 15 gusht dhe thotë:

14 "Clark tha që zyrtarët e UÇK-së nuk janë konsultuar në
15 mënyrë të drejtpërdrejtë me komandantët e aleancës gjatë
16 luftës që ka filluar më 24 mars kur NATO bombardoi
17 Jugosllavinë për të detyruar presidentin jugosllav Slobodan
18 Milosheviq për t'i dhënë fund spastrimit etnik kundër
19 popullatës shqiptare të Kosovës.

20 "Ne nuk kemi pasur komunikim të drejtpërdrejtë me ta
21 mesa di unë", tha Clark."

22 A është e saktë kjo, ajo çka keni thënë a është e saktë?

23 PË. Po, e saktë është.

24 PY. Në fakt ishte e rëndësishme që të mbahej një lloj
25 distance nga UÇK-ja gjatë bombardimeve. Domethënë, ju nuk

1 donit që të kishit kontakt të drejtpërdrejtë me UÇK-në, apo
2 jo?

3 PË. Jo, kjo nuk është e saktë. Për këtë arsye unë fola me
4 Thaçin. Në fakt i kërkoja Thaçit që të na ndihmonte. Ishim në
5 një pikë kritike të historisë, të vlerave, të etikës,
6 demokracisë në këtë kohë -- shpresoj që të mos më ndërpresë
7 Trupi Gjykses, megjithatë dua të shpjegoj që në një pikë të
8 caktuar -- atëherë, të nderuar Gjykatës, në qoftë se po flas
9 pak më shumë seç duhet ose shkoj përtej fushës së veprimit të
10 dëshmisë time më thoni. Por duhet të kuptoni që në një pikë
11 kur njerëzit luftojnë kundër shtypjes, në një pikë ata kalojnë
12 nga të qenit terrorist tek të qenit luftëtar lirie. Dhe në
13 një pikë të caktuar opinioni botëror dhe konsensusi botëror
14 mbërrijnë në përfundimin që njerëzit kanë të drejtë që të
15 rezistojnë presionin dhe luftës. Dhe kjo është e parashikuar
16 është e shkruar në Deklaratën Amerikane të Pavarësisë dhe
17 është edhe është diçka normale, e logjikshme.

18 Dhe diku në këtë spektër, që nga koha në 1974, kur Kosova
19 supozohej që të ishte një shtet i ndarë administrativisht,
20 Milosheviqi këtë e hoqi, e fshiu. Dhe në një pikë të caktuar
21 ca njerëz që quheshin terrorist në mënyrë kolektive u bënë
22 çlirimtarët e njerëzve, u bënë mbrojtja kolektive e popullit
23 të vet.

24 PY. Atëherë kalojmë pak tek një faqe tjetër e librit tuaj.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Për këtë do i kërkoja Sekretarit

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 49

1 që të paraqesë në ekran dokumentin DHT11130 deri në DHT11632,
2 faqja që jam i interesuar është DHT11483.

3 PY. Do ju tregoj kontekstin për bazën e pyetjes që t'ju bëj
4 së pari.

5 PË. A është e mundur që t'i referohem përsëri faqes së
6 mëparshme, faqes që kishim më përpara në ekran?

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
8 Dëshmitar, prisni që të bëhet pyetja njëherë.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe një herë faqja për të cilën
10 jam i interesuar është DHT11483.

11 PY. Kjo pjesa që ju shkruani këtu, Dëshmitar, ku thoni që:

12 "Paralajmërova që do të ketë vendime të tjera të
13 vështira, aftësitë e UÇK-së do të duhet që të shfrytëzohen
14 plotësisht (ne kishim shmangur në mënyrë rigoroze kontaktin e
15 drejtpërdrejtë me ta në Shqipëri, Pra, aspektet politike për
16 sa i takon marrëdhënies tonë të distancuar duhej që të
17 relaksoheshin, qasja në Serbi përmes Serbisë dhe deri në Danub
18 duhet që të bllokoheshin."

19 Pra, pjesa për të cilën unë jam i interesuar është kjo që
20 është në kllapa ku ju e keni bërë të qartë se e keni shmangur
21 kontaktin me UÇK-në kur keni shkuar në Shqipëri, kjo është
22 pjesë për të cilën jam i interesuar.

23 PË. Këto ka qenë udhëzimet politike nga procesi.

24 Megjithatë, dëshiroj që t'i kthehem dhe një herë pjesës
25 që më treguat pak më herët, dua të theksoj se -- mbase unë po

1 e tejkalvoja mandatin që kisha, por unë dëshiroja që të merrja
2 këshilla ose udhëzime ushtarake nga UÇK-ja për sa i takon
3 objektivave tona sepse një gjë e tillë do të lehtësonte
4 bombardimet tona, ndërhyrjen tonë, pra, të NATO-s. Dhe fakti
5 ishte që z. Thaçi nuk mund të na jepte këtë informacion sepse
6 ai nuk ishte pjesë e komandës dhe nuk kishte asnjë komandë dhe
7 kontroll efektiv dhe kjo ishte absolutisht shumë e qartë për
8 mua në atë kohë.

9 PY. Edhe një herë.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Shohim dokumentin 1289-03-TR-AT-
11 ET, faqja 2. Ekziston dhe transkripti në shqip i këtij
12 dokumenti. Kemi dhe një video të këtij materiali, megjithatë
13 nuk mendoj që është e rëndësishme për ta paraqitur në ekran
14 tani.

15 PY. Gjeneral, ju keni dhënë një intervistë për televizionin
16 kosovar në gusht të vitit 2020, dua që t'ju tregoj një pjesë
17 të shkurtër që keni dhënë në intervistën tuaj lidhur me temat
18 që sapo diskutuam. Është faqja e dytë e transkriptit. Atëherë
19 kemi këtë rreshtin përpara minutës 04:41:

20 "Megjithatë NATO nuk ka pasur marrëdhënie të
21 drejtpërdrejta me UÇK-në. Thjesht nuk kemi marrë raporte nga
22 ta si dhe nuk kemi pasur sesi të dimë se çfarë po ndodhte."

23 A është e saktë kjo?

24 PË. Po, kjo është e saktë.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, këtë duam që

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 51

1 ta parashtrojmë për pranim pak më vonë, jo aktualisht, por
2 aktualisht kërkojmë që të pranohet artikulli që i treguam
3 dëshmitarit më përpara.

4 Gjithashtu kërkojmë që të shtohet faqja DHT111483 tek
5 libri "Lufta moderne". Po ashtu dëshiroj t'ju them që ne nuk
6 është se kërkuam që të pranohej materiali për kontekst për
7 këtë libër --

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po diskutoni
9 për disa gjëra paralelisht, kështu që është mirë që t'i merrni
10 njëra pas tjetrës. Së pari po flisni për kontekstin për
11 marrëveshjen e thjeshtë, për dokumentin e parë që i treguat
12 dëshmitarit.

13 A ka ndonjë kundërshtim për këtë dokument?

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
16 Atëherë dokumenti SPOE00397623 deri në 00397624 pranohet.

17 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Ky dokument do të marrë
18 numrin e provës materiale P041, aktualisht i klasifikuar si
19 konfidencial.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Po, mund të jetë konfidencial.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni më
22 tej. Ky dokument riklasifikohet si publik.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Kërkojmë dokumentin DHT111483
24 që është ajo faqja të cilën e përdorëm nga libri i
25 dëshmitarit. Sa për qartësi për procesverbal, do të kërkojmë

1 gjithashtu dhe pranimin e dokumentit DHT11103 deri në 11108 si
2 material konteksti.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
4 kundërshtim?

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Kam nevojë për sqarim. A mund të
6 na thoni, materiali që thoni "materiali i kontekstit" për
7 çfarë e keni fjalën konkretisht?

8 Z. HALLING: [Përkthim] Ne po mundohemi që të japim
9 materialin ose informacionin minimal për të kuptuar më qartë
10 se çfarë thuhet në këtë libër. Është informacioni për të
11 drejtat e autorit.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim lidhur me
13 këtë.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
15 DHT111483 pranohet në prova.

16 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
17 Gjykatës. Kjo faqe do t'i shtohet provës P04514. Nëse e kam
18 kuptuar drejt, dokumenti DHT11103 deri në DHT11108 që
19 aktualisht ose aktualisht pjesë e të cilave u kërkuan nga
20 Prokurori për t'u pranuar do t'i shtohen provës ekzistuese
21 P04514.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, është e
23 saktë.

24 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
25 Gjykatës.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, për procesverbal
2 ka dhe fragmente të tjera nga ky libër të cilat ne do të
3 kërkojmë që të pranohen si prova jo gojore, pra, kërkojmë që
4 të futen si pjesë e provave ekzistuese, të mos i caktohet një
5 numër tjetër prove.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po është një
7 provë pa diskutim.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull.

9 Z. HALLING: [Përkthim] E kemi thënë dhe për herë të tjera
10 dhe për procesverbal, dëshirojmë të themi që nuk është se kemi
11 ndonjë kundërshtim për faqet të cilat janë pranuar si prova jo
12 gojore nga Mbrojtja e Thaçit.

13 PY. Gjeneral, ju keni diskutuar në kontaktet të
14 drejtpërdrejta marrëdhëniet e drejtpërdrejta me UÇK-në. Po
15 keni folur gjithashtu në paragrafin 25 të deklaratës tuaj që
16 nuk keni pasur mundësi që asnjëherë të merrnit ndonjë
17 informacion nga UÇK-ja në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të
18 tërthortë dhe nuk keni pasur mundësi që t'i përdorni këto
19 informacione dhe nuk pasur mundësi që ta përdorni UÇK-në si
20 vëzhgues, apo jo?

21 PË. Po.

22 PY. Keni bërë një lidhje midis kësaj dhe mungesës së
23 organizimit të mjaftueshëm të UÇK-së për të qenë në gjendje
24 për t'ju dhënë juve informacion?

25 PË. Po.

1 PY. Keni thënë se në -- këtë e thatë dhe në fakt në përgjigje
2 të Mbrojtjes së Krasniqit që edhe kjo merret në transkriptin
3 në kohë reale në faqen 76 që:

4 "... UÇK-ja mund ta ketë pas ditur, mund të ketë pasur
5 dijeni ... për sa i takon sulmeve mizore mbi popullatën por
6 nuk ekzistonte një përgjigje aktuale e koordinuar e
7 bashkërenduar për t'i raportuar NATO-s, për të bërë diçka
8 lidhur me këtë ose dhe në qoftë se ka ekzistuar ky informacion
9 asnjëherë nuk e kemi marrë."

10 A e keni thënë ju këtë gjë, Dëshmitar?

11 PË. Po, sa më kujtohet po.

12 PY. Përpara se të vazhdojmë më tej, ju flisni lidhur me
13 vëzhguesit dhe kur flisni lidhur me ta, ju po flisni lidhur me
14 ndihmën që dëshironit për objektet ose synimet e ndryshme që
15 ju dëshironi që të identifikonit, apo jo?

16 PË. Po.

17 PY. A pajtoheni që informacioni për objektet tuaja është
18 shumë sensitiv sa i takon kohës dhe që objektet mund të
19 ndryshonin me kalimin e kohës?

20 PË. Ndonjëherë ndodhte kështu.

21 PY. Në përgjithësi, a ishte informacion që ndryshonte, mund
22 të ndryshonte nga çasti në çasti dhe a ishte ky një aspekt i
23 rëndësishëm për t'u marrë parasysh në qoftë se ju do të
24 merrnit një informacion të tillë?

25 PË. Koha është gjithmonë faktor shumë i rëndësishëm për

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 55

1 vlerësimin e informacionit, por kjo nuk donte të thoshte që
2 objektivat ishin thjesht objektiva që lëviznin herë pas here.
3 Nuk mund të ishin të tilla. Sepse ka pasur vende të cilat ne
4 nuk i dinim që mund të ishin sekrete ose kishte gjëra të tjera
5 të kësaj natyre.

6 PY. Por ju dje na keni thënë që edhe një titull i caktuar në
7 qoftë se një grup civilësh shqiptarë janë detyruar që të
8 futeshin në një objektiv të fiksuar, kjo do të mund të
9 ndryshonte vetë përllogaritjet sa i takon këtij objektivi dhe
10 në këtë kuptim, domethënë, do kishim ndryshime në kohë reale,
11 a nuk është kështu?

12 PË. Nuk mund të them që është e saktë kjo që sapo thatë. Dhe
13 unë e kam thënë që informacion të mirë përlidhur me atë se
14 çfarë ka ndodhur në terren nuk është s'e e kemi marrë dhe këtë
15 e kam shpjeguar në hollësi në dëshminë time dje. Ju kam thënë
16 edhe si shembuj edhe incidentin e zjarrit ku neve në mënyrë të
17 gabuar goditëm një objektiv që mendonim që ishte një objekt i
18 cili mendonim që ishte i serbëve. Por ndërkohë na doli tjetër
19 situata në terren.

20 Dhe kjo është diçka që e kemi bërë dhe me mbështetjen e
21 Sekretarit të Përgjithshëm Solana.

22 PY. Do shohim diçka që ju e keni thënë në librin tuaj.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretarit të
24 paraqesë në ekran dokumentin DHT11103 deri në 111632, faqen
25 111472.

1 PY. Ndërkohë që paraqitet kjo faqe në ekran, besoj se ju jeni
2 informuar lidhur me operacionin e UÇK-së në Pashtrik në vitin
3 1999. Ju e diskutoni këtë në libër, apo jo?

4 PË. Po.

5 PY. Dëshiroj që t'ju bëj një pyetje që është trajtuar në një
6 prej faqeve të librit tuaj që ka të bëjë me operacionin. Pra,
7 ky operacion ishte disi domethënës apo me rëndësi për NATO-n.
8 A është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

9 PË. Çfarë më kujtohet mua është që ne kemi marrë vetëm ca
10 informacione bazike rudimentare edhe se ekzistonte një
11 përpjekje nga UÇK-ja për të penetruar nga Shqipëria për në
12 Kosovë. Por pavarësisht grupeve të ndryshme të UÇK-së e
13 rëndësishme ishte që theksohej që bëhej fjalë për vende të
14 ndryshme të izoluara në të gjithë Kosovën.

15 Pra, po, unë kam qenë në dijeni për të bërë përpjekjet që
16 po bëheshin nga UÇK-ja në mënyrë që forcat e tyre të vinin në
17 Kosovë. Dhe sa i takon informacionit, në qoftë se ky
18 informacion ka qenë i dobishëm për mua, apo jo, sepse serbët
19 mund të sulmonin këtë forcë, pa diskutim që ky ka qenë
20 informacion i rëndësishëm si objektiv për neve.

21 PY. Tani dëshiroj që t'ju bëj një pyetje tjetër që ka të bëjë
22 me UÇK-në dhe a mund të na thoni se si ndodhi që forcat serbe
23 mund të targetoheshin ose mund të etiketoheshin prej jush.

24 Atëherë në librin tuaj ju përdorni fjalën "rudimentare".
25 Pra, ju thoni në librin tuaj që:

1 "Në mëngjesin e datës 26 keni pasur informacion të
2 konsiderueshëm lidhur me planet e UÇK-së për të sulmuar në
3 Kosovë."

4 Nga e keni marrë këtë informacion?

5 PË. Kam pasur forca speciale në terren të cilët bënë
6 ndërldhjen, megjithatë nuk e mbaj mend personin ose emrin e
7 personit që ma ka dhënë këtë informacion.

8 PY. Kalojmë tek faqja tjetër, këtu thotë që:

9 "Unë po inkurajoja shkëmbimin e informacionit ndërmjet
10 Task Forcës dhe Qendrës Operacioneve Ajrore që është (CAOC) në
11 Vincenza. Unë kisha kontakte të vazhdueshme të drejtpërdrejta
12 me ushtrinë shqiptare dhe nga ana tjetër ato po monitoronin
13 UÇK-në dhe kishte shumë objektiv që po e kalonin CAOC-së."

14 Duket sikur ju po merrnit informacion nga UÇK-ja në
15 mënyrë të tërthortë nga Shqipëria, nga ushtria shqiptare, apo
16 jo?

17 PË. Mendoj se po.

18 PY. I takon që keni marrë informacion të tërthortë nga UÇK-ja
19 dhe nuk është e saktë plotësisht ajo çfarë thatë më herët, apo
20 jo?

21 PË. po, mund të qartësohet kështu.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Dëshiroj që të shkojmë në një
23 tjetër dokument, për këtë në të shohim librin tuaj në faqen
24 DHT111472 deri në DHT111473, më konkretisht duam që këto faqe
25 të cilat i pamë t'i shtohen provës P04514.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka
2 kundërshtim?

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
5 111472 deri në 111473 do të pranohet.

6 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
7 Gjykatës. Këto faqe do t'i shtohen provës P04514.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Tani do kërkoja që të paraqitet në
9 ekran dokumenti 077978 deri në 077982-ET E Rishikuar 1, faqja
10 077981.

11 PY. Gjeneral, ky është një dokument i 1 prillit 1999. Është
12 urdhër i ministrit të mbrojtjes të Qeverisë së Përkohshme të
13 Kosovës.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Do i lutesha Sekretarit të kalojmë
15 në fund të dokumentit.

16 PY. Besoj që e shikoni që ky është një dokument i nënshkruar
17 nga Azem Sylja, që është një person që ju thatë që nuk e
18 njihni, nuk e keni dëgjuar dje. Kalojmë tek pika 5. Pika 5 e
19 këtij dokumenti thotë:

20 "Caktoj Agron Haradinaj si shef i organizimit dhe
21 komunikimit dhe koordinator ndërmjet UÇK-së, NATO-s dhe
22 Forcave të Ushtrisë së Shqipërisë."

23 Pra, UÇK-ja ka emëruar dikë apostafat që të shërbente si
24 koordinator ose si ndërlidhës ndërmjet NATO-s, Ushtrisë së
25 Shqipërisë dhe UÇK-së. A e keni ditur këtë informacion,

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 59

1 Dëshmitar?

2 PË. Jo.

3 PY. Në rregull.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Tani kalojmë tek një tjetër

5 dokument P642, më konkretisht faqja SPOE0023151.

6 PY. Dokumenti që do të shikojmë pas një çasti, Gjeneral, e
7 kemi sekuestruar nga banesa e Jakup Krasniqit. Atëherë, tani
8 SPOE00231512, atëherë besoj që lexoni këtu në fillim fare ku
9 thotë seksion për "Bashkëpunimin me NATO-n":

10 "Bashkëpunimi me NATO-n ishte i përditshëm dhe siç del
11 nga njoftimet operative që i disponojmë në dosjen e
12 Operacionit Shigjeta ..."

13 Dhe besoj se sipër në pjesën e epërme të dokumentit
14 shikoni përsëri të njëjtin person, Agron Haradinaj, "Shefi i
15 Organizativ i UÇK-së".

16 A keni qenë në dijeni që ka pasur bashkëpunim të
17 përditshëm të UÇK-së me NATO-n?

18 PË. Ne me aq sa shikoj këtu -- atëherë ne kishim një ekip që
19 e kishte qendrën në Kukës, e di që ka qenë ky ekip. Se si ka
20 qenë organizuar formalisht nga ana e UÇK-së këtë nuk mund
21 t'jua them, se nuk e kam ditur asnjëherë.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Edhe një dokument të fundit P787,
23 SITF0009126.

24 PY. Dokumenti që do shikoni në ekran është një dokument,
25 është dëshmi e Kadri Veselit në çështjen gjyqësore të Arben

1 Krasniqit e të tjerë, më datën 26 shtator 2011. Në qoftë se do
2 shikoni dokumentin që keni para në ekran në pyetjen 14, pak më
3 poshtë në dokumentin që keni përpara, pra, pyetja është kjo:

4 "Gjatë bombardimit të NATO-s a e keni parë përsëri z.
5 Limaj?"

6 Përgjigja që thotë z. Veseli është kjo:

7 "E kam parë gjatë një takimi të Shtabit të Përgjithshëm
8 gjatë së cilës kemi diskutuar për çështjen e komunikimit. Një
9 problem që zakonisht kishim si ushtri ishte që të mblidhnim
10 informacion lidhur me pozicionet e armikut dhe t'ua kalonim
11 këto informacione partnerëve ndërkombëtarë."

12 Pra, UÇK-ja ju ka dërguar këtë informacion juve
13 pavarësisht në qoftë se e keni kërkuar në mënyrë të
14 drejtpërdrejtë apo jo këtë informacion. A keni qenë në dijeni
15 të kësaj?

16 PË. E di që ata po përpiqeshin të na e dërgonin këtë
17 informacion, po nuk e di në qoftë se ky informacion ka
18 përfunduar tek ne apo jo. Ne në maj e dinim, kishim
19 informacion lidhur me operacionin e Pashtrikut.

20 PY. Në rregull. Do ta diskutojmë këtë çështje pas pushimit.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Por, të nderuar Gjykatës, dua t'ju
22 them që tri dokumentet që ju treguam nga këto tri dokumente,
23 dokumenti i fundit është i pranuar në prova, por faqja 077981,
24 që është urdhri për emërimin e Agron Haradinaj nuk është i
25 pranuar në prova. Një tjetër faqe që është pjesë e të njëjtit

1 dokument, pra, këtë faqe duam që t'i shtohet provës P02499.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
3 kundërshtim?

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faqja 077981
6 do të pranohet, do t'i shtohet provës ekzistuese P02499.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Duke marrë parasysh kohën, besoj
9 se është momenti i përshtatshëm për të bërë pushimin tani. Dhe
10 dua t'ju informoj që do përfundojmë pyetjet tona në seancën
11 tjetër.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
13 pushim për gjysmë ore tani, Dëshmitar.

14 DËSHMITARI: [Përkthim] Në rregull.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do shihemi
16 përsëri për gjysmë ore.

17 DËSHMITARI: [Përkthim] Edhe një herë faleminderit.

18 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
20 pushim deri në orën 11.30.

21 --- Pauza fillon në orën 11.00

22 --- Seanca rifillon në orën 11.32

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë
24 kundërshtim për ato - [Mikrofoni çaktivizuar].

25 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Po flasim për dy gjëra të
2 ndryshme.

3 Z. DIXON: [Përkthim] Po, po flas për dokumentet e
4 identifikuara në fillim të seancës së sotme, te dokumentet që
5 përmbanin korrigjime.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

7 Z. DIXON: [Përkthim] I kontrolluam ato, i verifikuam
8 dokumentet, nuk kemi kundërshtime.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka
10 kundërshtime për ato, në rregull.

11 Z. DIXON: [Përkthim] Por, pika tjetër është ajo me të
12 cilën do të merret z. Misetic.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Për procesverbal, ne do të
14 kundërshtojmë pranimin si me numër provizor të provës.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ta trajtoj
16 fillimisht këtë dokumentin e parë, materialin e parë.

17 Pasi dëgjuam kundërshtimet, Trupi Gjykses urdhëron CMU-në
18 të vazhdojë me çështjen në vijim. Së pari, P00515_ET.77 do të
19 zëvendësohet nga 008879 deri në 008881-ET, me këtë pjesë,
20 F03214 dhe së dyti 066769 deri në 066769-ET do t'i shtohet
21 provës materiale P01616, së treti P00310-ET do të zëvendësohet
22 nga SPOE00056467 deri në SPOE00056467-ET, e rishikuar. Katër,
23 125893-02-TR/125893-02-TR-ET do t'i shtohet provës materiale
24 ekzistuese P04221, së pesti P01712.1-ET do të zëvendësohet nga
25 060119-TR-ET , Pjesa 1, Rishikuar RED. Gjashtë, P01086-

1 ET/P01086-AT do të zëvendësohet nga 061427-03-TR, e rishikuar,
2 dhe 061427-03-TR Rishikuar ET; së shtati, faqja SPOE00231058 e
3 provës materiale P01091-ET do të zëvendësohet nga faqja
4 SPOE00231058 e SPOE00231037-SPOE00231118-ET, e rishikuar.

5 Me kaq përfundon urdhri gojor i Trupit Gjykses.

6 Tani, kundërshtimin tuaj, z. Misetic.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Sa i takon provës materiale P4515
8 me numër provizor P4516, qëndrimi ynë është se ato janë
9 deklarata sipas urdhrit gojor të Trupit Gjykses në faqen e
10 transkriptit 27162 deri në 27164.

11 Prokurori sot në mëngjes sugjeroi se ato nuk ishin të
12 tilla dhe se dëshmia përpara Senatit nuk është marrë në
13 përputhje me synimet apo qëllimet e zbatimit të ligjit. Ne
14 paraqitëm një provë materiale nga çështja civile që u
15 përjashtua mbi këtë bazë. Trupi Gjykses konstatoi se ajo që
16 nevojitet është që deklarata të jetë e natyrës, në natyrë e
17 llojit si dëshmi, dhe që të jetë dhënë në lidhje me procedura
18 ligjore.

19 Kjo deklaratë -- këto dy deklarata janë dhënë nën betim
20 në një seancë dëgjimore të Senatit. Ne vlerësojmë se kjo është
21 dëshmi, është e natyrës, pra, si dëshmi, dhe dhënë me
22 procedurë ligjore. Dhe kjo është pjesë e përgjegjësisë të
23 mbikëqyrura të Senatit, dhe referenca për provën materiale të
24 Prokurorisë P942 është e pavend dhe e papërshtatshme sepse kjo
25 provë materiale merret me parlamentarë të cilët flasin në

1 parlament. Nuk është seancë dëgjimore për prova me një
2 dëshmitar që jep dëshmi nën betim. Këto janë deklaratat të
3 dhëna nga parlamentarë në parlament. Faleminderit.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mund të
5 përgjigjem shkurtimisht.

6 Përkufizimi është dhënë nga ky Trup Gjykues për
7 deklaratën, dhe është dhënë në F01380 RED, paragrafi 12(1) dhe
8 është si në vijim:

9 "Ato duhet të përbëjnë ose të jenë pjesë e një 'deklarate
10 me shkrim të dëshmitarit', deklaratë e marrë në kontestin e
11 një hetimi penal apo procedurave penale ...".

12 Vendimi që përmendi avokati pak pas, tani në këtë çast,
13 shkon përtej përkufizimit të procedurës civile, dhe kjo nuk
14 është as njëra as tjetra. Kjo është një procedurë, nuk është
15 procedurë e të njëjtës natyrë. Është më afër seancës dëgjimore
16 parlamentare dhe për këtë arsye kjo dispozitë nuk zbatohet në
17 këtë rast.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Misetic, meqenëse jeni
19 në këmbë, do t'ju përdor juve. A mund të na thoni cili është
20 dallimi mes dokumentit që po ofrohet tani dhe dokumentit që
21 keni ofruar ju që tanimë është pranuar si provë materiale
22 1D290, që është në, që është raport i seancës dëgjimore të
23 Senatit që ju i keni paraqitur z. Rubin, thjesht që ta
24 kujtoni, dhe i keni paraqitur atij pjesën e dëshmisë së tij që
25 ka dhënë Senatori të atëhershëm Biden?

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 65

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Senatori Biden nuk është dëshmitar
2 në atë procedurë, nuk është dëshmi në natyrë kjo gjë. Kjo
3 është, në këtë rast kemi një dokument që është tërësisht
4 dëshmi nga natyra e saj. Dhe Gjenerali Clark ngriti dorën e
5 tij dhe u betua se do të thojë të vërtetën kur të merret në
6 pyetje. Pra, ky është dallimi themelor dhe përputhet tërësisht
7 me përkufizimin tuaj.

8 Dhe nëse mund t'i përgjigjem z. Halling, asgjë në
9 përkufizimin e cituar nuk thotë se ka, po të shkojmë përtej
10 kufizimit të ligjit të së drejtës penale të deklaratës së, në
11 një procedurë të vetme, apo në një proces të vetëm. Po lexoj
12 kufizimin që është:

13 "Mjafton që deklarata në fjalë të jetë në një natyrë si
14 dëshmi dhe të jetë dhënë në lidhje me procedura ligjore". Kaq.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
16 Do të marrim një vendim për këtë.

17 Tani mund të sillni dëshmitarin në sallë.

18 [Dëshmitari vijon dëshminë]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
20 Mund të vazhdojmë.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

22 PY. Do të vazhdoj tani aty ku e lamë përpara pushimit, por do
23 t'ju bëj një pyetje lidhur me diçka që thatë dhe kjo është në
24 faqen 42 të transkriptit ku ju flisni për marrëveshjen e
25 Rambujesë, dhe kam një pyetje lidhur me këtë, lidhur me

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 66

1 përgjigjen. Pra, po citoj:

2 "UÇK-ja e firmosi, nënshkruajti marrëveshjen e Rambujesë,
3 por mendoj -- mendoj që po bëhej rekrutim dhe po siguroheshin
4 armë në një moment të caktuar pas marrëveshjes, nënshkrimit të
5 marrëveshjes së Rambujesë, kur serbët e refuzuan të
6 nënshkruajnë marrëveshjen, ne u përfshimë në konflikt. Nuk kam
7 marrë asnjëherë hollësi të kësaj, por është përshtypja ime që
8 ata kanë marrë një lloj mbështetje nga vende të caktuara".

9 Tani e kuptoj që ju nuk e dini përgjigjen e kësaj
10 pyetjeje, por më -- dhe ju kujtoj se në qoftë se kam ndonjë
11 kufizim që vjen nga rregulla, sipas rregullës 107, kufizimet e
12 konfidencialitetit lidhur me këtë që po ju pyes, por a jeni në
13 gjendje të konfirmoni nëse janë siguruar dhe dhënë armë UÇK-së
14 nga organe apo entitete qeveritare të ndonjë vendi anëtar të
15 NATO-s?

16 PË. Nuk mund ta konfirmoj këtë.

17 PY. Për shkak të arsyeve të konfidencialitetit? Kjo është
18 arsyeja?

19 PË. Thjesht nuk e di.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Përfaqësuesja ligjore dëshiron të
21 flasë.

22 [Dëshmitari dhe Përfaqësuesja e Qeverisë së
23 SHBA-së konsultohen]

24 DËSHMITARI: [Përkthim] Nuk e di përgjigjen.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Kaq doja të dija.

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 67

1 PY. Tani, të kthehemi. Më parë, përpara pushimit po thonit se
2 me sa duket UÇK-ja po përpiquej të dërgonte informacione NATO-
3 s, por ju nuk e dini nëse ky informacion ka arritur.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Për këtë do të doja të shfaqim në
5 ekran dokumentin SPOE00406592 deri në 00406597. Në fakt mund
6 të fillojmë shkurtimisht në faqen e parë të dokumentit për të
7 parë se për çfarë bëhet fjalë, dhe më pas do të kalojmë në
8 faqen e fundit.

9 PY. Në krye të faqes shihet që është një raport informimi i
10 Ministrit të Punës së Jashtme britanik Robin Cook, lidhur me
11 operacionet e NATO-s në Kosovë.

12 PË. Po.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Tani kalojmë në faqen e fundit. Në
14 fund të faqes.

15 PY. "Pyetje: Ka patur raporte se UÇK-ja po i kërkon
16 Perëndimit ndihmë për furnizim me armë. Cilat janë komunikimet
17 që keni me UÇK-në dhe a kanë kërkuar ata armë? Në qoftë se po,
18 a do t'ju jepni atyre armë?"

19 Përgjigje:

20 "Ne kemi marrë një numër, disa raporte nga UÇK-ja ditëve
21 të fundit dhe dy javët e fundit dhe është, na ndihmon që të
22 kemi perspektivën e tyre mbi atë që po ndodh brenda Kosovës.
23 Por nuk synojmë, nuk kemi qëllim që t'i furnizojmë ata me
24 armë, sepse kjo gjë do të ishin, do të përbënte shkelje të
25 embargos së Kombeve të Bashkuara ndaj Jugosllavisë".

1 Tani, Gjeneral, britanikët duket sikur merrnin
2 informacion nga UÇK-ja, e shikoni këtë?
3 PË. Nuk e shikoj këtë. Një sekondë, më lejoni ta lexoj prapë.
4 PY. Natyrisht. Do t'ju jap një çast që ta lexoni. Është
5 rreshti i parë.
6 PË. Po, nëse më lejohet do ta interpretoj këtë. Jam i sigurt
7 që ka patur deklarata nga dikush që ka thënë UÇK-ja po troket
8 në derë dhe kanë kërkuar ndihmë. Kjo është tërësisht ndryshe
9 nga të pasurit një, e një sistemi të komandës dhe kontrollit
10 të unifikuar, që do të mbështeste NATO-n. Dhe kur filluan këtë
11 bisedë dje, kështu e kam kuptuar unë fillimin e të gjithë
12 kësaj, pra lidhur me ekzistencën e kontrollit dhe komandës.
13 Dikush më pyeti, nuk më kujtohet a ishit ju apo Mbrojtja, që
14 të jepja përkufizimin e kontrollit dhe të komandës.
15 Dhe siç e dini fakti që ka patur, ka komunikime të tilla
16 dhe dikush thotë ndihmë, ndihmë, nuk do të thotë komandë dhe
17 kontroll.
18 PY. Pyetja ime ishte më e thjeshtë se kaq. Thjeshta doja të
19 dija nëse ju e dinit se britanikët kishin marrë një numër
20 raportesh nga UÇK-ja.
21 PË. E dija se ata kanë marrë kërkesa, nuk e dija çfarë, çfarë
22 ishin këto raporte.
23 Z. HALLING: [Përkthim] Tani do të kalojmë ndoshta tek një
24 burim amerikan, SPOE00406608 deri në 00406620.
25 PY. Gjeneral, ju kujtohet që dje ju treguan një video nga

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 69

1 zëdhënësi i Pentagonit, Ken Bacon?

2 PË. Po.

3 PY. Kjo është një tjetër raport informimi dhe do pres që të
4 shfaqet në ekran. Është i datës 17 maj 1999, e shikoni aty?

5 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe në qoftë se kaloni në faqen
6 SPOE00406611, më poshtë në faqe. Pak më poshtë, drejt fundit.
7 Po, këtu.

8 PY. Këtu mund të shihni në përgjigjen ndaj pyetjes, kjo
9 sugjeron që strategjia e tij po funksionon, pjesë e përgjigjes
10 së Bacon është:

11 "Ne nuk i kemi shifrat të mira lidhur me -- të sakta
12 lidhur me numrin e trupave që janë, që kanë, që janë humbur,
13 pra, vdekur. Nuk kemi raporte, raporte anekdotike përmes UÇK-
14 së apo burimeve të tjera të njësive që nuk janë në gjendje të
15 lëvizin sepse ata nuk kishin karburant apo furnizime.
16 Natyrisht, disa prej këtyre njësive vazhdojnë të jenë në
17 lëvizje, por ka një ardhje të vazhdueshme të informacionit se
18 sulmet po japin efekt".

19 Pra, Departamenti i Mbrojtjes gjithashtu ishte, të paktën
20 në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, po merrte informacion të
21 njëjtë. A është kështu?

22 PË. Po, por ka një dallim mes siç -- gjatë fushatës që po
23 ndodhte, cila ishte data dhe një herë e Bacon?

24 PY. 17 maj 1999.

25 PË. Në rregull. Dhe ka vazhduar nga 24 marsi deri në fund të

1 majit, në fillim të qershorit. Ju cituat diçka nga libri,
2 mendoj ka qenë data 26 maj kur ne kemi, po merreshim me
3 çështjen e malit të Pashtrikut. Nuk ka, nuk vihet në dyshim që
4 të gjithë po përpiqeshin të merrnin informacion nga UÇK-ja. Ne
5 duhej të merrnim sa më shumë informacion që të mundeshim nga
6 terreni dhe gradualisht kemi marrë më shumë informacion. Po e
7 merrnim nga të gjitha burimet e mundshme.

8 Por siç e thashë në deklaratat e mia dje, më duket që
9 duke iu përgjigjur Mbrojtjes, nuk kam marrë asnjë gjë nga z.
10 Thaçi, i cili siç e dini ka qenë, pretendohet të ketë qenë
11 përgjegjës. Tek unë nuk ka ardhur. Është nxjerrë nga nivele më
12 të ulëta, nga njerëzit në biseda joformale, dhe kam patur
13 përshtypjen se nga njerëzit e forcave të mia speciale që ishin
14 në Kukës, pra përshtypjet e tyre kam marrur. Kam patur dy
15 persona atje nga njësia operacioneve speciale të ushtrisë
16 amerikane, e Komandës së Operacioneve Speciale në Evropë dhe
17 mendoj se ata merrnin informacione nga njerëzit bisedonin. Nuk
18 kam patur asnjëherë përshtypjen se kishte ndonjë lloj
19 raportimi formal që vinte dhe për t'ju treguar, për të treguar
20 komandën. Ata kanë marrë informacionet në mënyrat ashtu siç
21 kanë mundur.

22 Dhe e njëjta gjë edhe me shënjestrimin, me identifikimin
23 dhe shënjestrimin e shënjestrave. Dhe kjo është përshtypja
24 ime, nuk më kujtohet data. Në fakt kam shkuar në Kukës, kam bë
25 një rekonisansë të terrenit dhe të itinerarit. Ne do shkonim

1 për të pushtuar një vend, pra, dhe kam marrë edhe Ministrin e
2 Mbrojtjes së Shqipërisë me mua gjatë atij udhëtimi. Pra, kemi
3 bërë këtë gjë për, me njerëzit e NATO-s për të marrë
4 informacion nga këta njerëz në terren.
5 PY. Në rregull.

6 Z. HALLING: [Përkthim] SPOE00406266 deri në 00406436.

7 PY. Gjeneral, e kuptoj përgjigjen tuaj dhe dallimin që bëni
8 mes mosmarrjes së informacionit formal dhe raportit formal,
9 por megjithatë keni marrë informacione. Ajo që po shfaqet në
10 ekran tani është raporti i vitit 2002, përgatitur nga ushtria
11 amerikane, Rand. A jeni, njihenit me Rand?

12 PË. Sigurisht.

13 PY. A mund t'i shpjegoni Gjykatës se çfarë është?

14 PË. Është një institucion hulumtimi i financuar nga qeveria.

15 PY. Siç e shihni në raport, quhet "lufta e ndërprerë" dhe jo
16 e unifikuar. E njihni këtë raport?

17 PË. Jo.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Të kalojmë në faqen SPOE00406372
19 dhe mund të shihni në fund të paragrafit këtu:

20 "Për më tepër gjatë majit raportet nga UÇK-ja u bënë një
21 burim i rëndësishëm i informacionit të zbulimit dhe
22 informacion për shënjestrimin e task, pra për Task-Forcën
23 Hawk. Të dhënat nga këto burime u vunë, u trajtuan dhe
24 analizuan nga celula për koordinimin e operacioneve në
25 thellësi për të pasur një pasqyrë të forcave jugosllave që

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 72

1 vepronin në jugperëndimin e Kosovës".

2 Gjeneral, kjo është edhe një tjetër tregues se ky

3 informacion nga UÇK-ja ka ardhur tek juve, apo jo?

4 PY. Unë kam shkuar atje, jam ulur me Task-Forcën Hawk, kam

5 bërë një celulë koordinimi për operacionet në thellësi, në

6 prapavijë, dhe kam kërkuar që të nxirret sa më shumë

7 informacion që të ishte e mundur. Dhe siç e dini kur shihen,

8 por këto deklarata, kështu nuk më kujtohet ky raport në

9 konkret, ndoshta kanë folur me mua, nuk e di, nuk më kujtohet.

10 Nuk më kujtohet ta kem lexuar. Por ne kemi bërë gjithçka që

11 kemi patur mundësi të bënim.

12 Por siç e dini kjo është ndryshe nga përpjekja për të

13 nxjerrur informacione nga një forcë siç ishte UÇK-ja. Dhe

14 ishte tërësisht ndryshe nga të pasurit e një raporti nga

15 aleatët që e kishin strukturë, radio, sistem raportimi dhe të

16 gjitha këto gjëra. Të paktën unë kam menduar që bazohej në

17 cilësi për sa i përket shënjestrimeve.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Kalojmë në SPOE00406412.

19 PY. Ju thatë më herët në përgjigjen tuaj më të fundit se nuk

20 ju kujtohet se ata kanë biseduar me ju.

21 PË. Natyrisht që kanë biseduar.

22 PY. Kjo është ajo që po thoja,

23 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe, të nderuar Gjykatës, do të

24 kërkoja që të paraqes këto dokumente tre prova materiale që iu

25 treguan dëshmitarit, dhe këto është raporti i informimit nga

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 73

1 Cook, që është SPOE00406592 deri në 00406597 , raporti i Bacon
2 që është SPOE00406608 deri në 00406620. Dhe Rand, që iu tregua
3 dëshmitarit, që është SPOE00406266, dhe pastaj faqja 406372.
4 Dhe në fund faqja 406412.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
6 kundërshtim?

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Kam një kundërshtim në parim, por
8 pyes veten pse na duhen të gjitha këto prova për provën e
9 parë, apo të pranojmë vetëm pjesë të saj që iu treguan
10 dëshmitarit.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Janë të dyja raportet të shkurtra,
12 ia lëmë Trupit Gjykses që të vendosë nëse prova në tërësi të
13 pranohet apo vetëm faqja që treguan dëshmitarit.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për synime të
15 kontekstit. Në qoftë se s'ka diçka tjetër, mund t'i pranojmë.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Po bëja llogari, janë 14 faqe, dhe
17 vetëm një iu tregua dëshmitarit.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Faqja e parë e secilit dhe faqja
19 pas saj, pra katër faqe u treguan.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Provat e
22 përmendura pranohen të gjitha.

23 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] SPOE00406592 deri në
24 SPOE00406597, faqet SPOE00406592, dhe faqja SPOE00406597 do të
25 pranohen në numrin e provës materiale P04519, aktualisht

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 74

1 klasifikuar si publik.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe që të konfirmojë Sekretari i
3 Gjykatës, nëse mundet. U pajtuam që të pranohen si provë
4 materiale dhe jo vetëm dy faqet individuale që ju treguam, por
5 dokumenti në tërësi.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kështu e kemi
7 kuptuar edhe ne.

8 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Atëherë, ne po pranojmë
9 vetëm faqen e parë dhe faqen 611, apo të gjithë dokumentin?

10 Z. HALLING: [Përkthim] Edhe për atë, pra do të jetë
11 406608 deri në 406620.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Këto, doja të thoja, janë 12 faqe
13 me sa kuptoj dhe po shpresoj thjesht të pranohet ajo që i
14 është treguar dëshmitarit. Nuk pata mundësi që t'i lexoj 12
15 faqe.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jeni i
17 shqetësuar për përmbajtjen, doni të dini përmbajtjen e
18 dokumentit?

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk iu paraqit dëshmitarit, pra
20 nuk kam problem që t'i tregohet dëshmitarit dhe t'i kërkohet
21 atij të bëjë komente lidhur me këtë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet,
23 natyrisht që ju mund t'ia tregoni atij.

24 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] SPOE00406608 deri në
25 00406620 do të marrë numrin e provës materiale P04520,

1 aktualisht klasifikuar si publike. Dhe i fundit, ERN

2 SPOE00406266, deri në SPOE004063 --

3 Z. HALLING: [Përkthim] Në qoftë se mund të më ndihmojë
4 Sekretari i Gjykatës për këtë, ne po dorëzojmë vetëm faqet e
5 treguara sepse është raport i gjatë dhe mund t'i përsëris
6 faqet që po kërkojmë të pranohen, janë SPOE00406266, deri në
7 406372 dhe 406412. Këto janë për këtë.

8 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Në atë rast atëherë, kjo
9 do të marrë numrin e provës materiale P04521, dhe klasifikimi
10 është publik. Faleminderit.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit. Dhe tani mund ta
12 heqim dokumentin.

13 PY. Gjeneral, a është e vërtetë apo jo, se hera e vetme që ju
14 jeni takuar me ndonjë nga UÇK-ja gjatë fushatës së
15 bombardimeve ajrore, ka qenë takimi me Hashim Thaçin që
16 përmendët ju në deklaratën tuaj, që ndoshta ka ndodh në 1999,
17 është e saktë?

18 PË. E saktë.

19 PY. Ku është bërë ky takim?

20 PË. Më kujtohet që e kam takuar atë në bazën ajrore.

21 PY. Është bërë një takim në mars të 1999, në bazën ajrore.

22 PË. Po, ky është.

23 PY. Unë po flas për një takim pas këtij takimi. Ju tha që ka
24 qenë ndoshta në prill.

25 PË. Po. Mund të ketë ardh në zyrën time, më kujtohet në

1 mënyrë të vagullt. Por nuk jam kthyer atje. Nuk jam i sigurt
2 që a kam në letrat e mia, që janë në Fort McNair, dhe janë të
3 klasifikuara, në dokumentet e mia. Thjesht duhet të shkoj dhe
4 t'i shqyrtoj, t'i konsultoj ato dokumente.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Që të jemi të qartë, do të kërkoj
6 të shfaqet në ekran 1D00430, paragrafi 23.

7 PY. Dhe të flasim për takimin e saktë me z. Thaçi për të
8 cilin po flas, konkretisht që të jem i sigurt që pyetjet janë
9 të qarta, pyetjet që do vijojnë pastaj.

10 PËRKTHYESI: Shënim i përkthyesit: Kërkojmë që folësit të
11 flasin më ngadalë.

12 Z. HALLING: [Përkthim] E morëm parasysh.

13 Është paragrafi 23.

14 PY. Ky takim:

15 "Më kujtohet që jam takuar me z. Thaçi një herë të tretë
16 diku në një kohë gjatë fushatës së bombardimeve, ndoshta në
17 prill të 1999, për të kërkuar ndihmën e tij me identifikimin e
18 vendeve, shënjestrave për bombardimet e NATO-s".

19 A ju kujtohet ku është mbajtur ky takim?

20 PË. Jam i sigurt që është mbajtur në selinë time.

21 PY. Në kohën e këtij takimi, si e keni kuptuar ju se cili
22 ishte roli i z. Thaçi?

23 PË. Unë e kam, ai ishte si oficer ndërlihdhjeje, kam kuptuar
24 se ai po kërkonte para dhe mbështetje nga diaspora, komuniteti
25 i diasporës shqiptare.

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 77

1 PY. Pra, a kërkuat ju të takoheshit me të, apo kërkoi ai që
2 të takohet me ju?

3 PË. Nuk më kujtohet. Ndoshta kam kërkuar ta takoj sepse po
4 kërkoja, isha akoma në kërkim të ndihmës për të identifikuar
5 shënjestrat.

6 PY. Dhe në fund ju u takuat me z. Thaçi sepse ishte një nga
7 personat më të lartë të UÇK-së, dhe si SACEUR ju takoheshit me
8 njerëz të nivelit të lartë, më të lartë.

9 PË. Dhe ai supozoj, mendohej të ishte një nga njerëzit më të
10 lartë.

11 PY. Tani duhet të konfirmoj datën e saktë të këtij takimi.

12 Z. HALLING: [Përkthim] Në qoftë se mund të kalojmë te
13 SPOE00405042 dhe 00405042.

14 PY. Kjo është një artikull i medias që kemi gjetur, nga data
15 28 maj 1999, dhe dua t'ju tregoj atë për t'ju treguar nëse ky
16 është takim i njëjtë për të cilin po flasim. Këtu thuhet:

17 "Shefi UÇK-së takohet me zyrtarët e lartë të NATO-s në
18 Bruksel".

19 Data e dokumentit është 28 maj 1999:

20 "Thaçi tha që planifikon që të takohet me Sekretarin e
21 Përgjithshëm të NATO-s Javier Solana dhe Komandantin e
22 Aleancës Wesley Clark".

23 A mendoni që është ky takim, Dëshmitar?

24 PË. Jo, nuk mendoj që është ky takim.

25 PY. Ju thoni që keni pasur vetëm tre takime.

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 78

1 PË. Jo.

2 PY. Pra, atëherë deri në fund të fushatave ju thoni që keni
3 pasur tre takime, dhe takimi i fundit ka qenë në prill të
4 1999. Po ky takimi, çfarë takimi është?

5 PË. Nuk e di. Nuk më kujtohet të kem marrë pjesë në këtë
6 takim. Ju kërkoj ndjesë, ju kërkoj ndjesë Trupi Gjykues sepse
7 mund të kisha lexuar shumë më tepër se sa lexova, sepse nuk e
8 dija se çfarë donit ju që t'ju përgjigjesha. Mbase do kishte
9 qenë mirë që të lexoja më shumë për të përmbushur detyrimet e
10 mia si dëshmitar. Ju kërkoj ndjesë, këtë takim nuk e mbaj
11 mend.

12 Z. HALLING: [Përkthim] Tani le të kalojmë te prova
13 P814_ET.17, që është nga arkivi i luftës i artikujve që janë
14 botuar në KosovaPress.

15 PY. Këtu thuhet:

16 "Kryeministri Thaçi mori pjesë në takimin e Këshillit të
17 NATO-s në Bruksel".

18 Ose më tej thuhet që:

19 "Dje Kryeministri i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës
20 Hashim Thaçi e kaloi ditën në Bruksel."

21 Është artikull i datës 29 maj, në Bruksel. Dhe thuhet në
22 paragrafin e dytë që:

23 "Z. Thaçi gjithashtu ka pasur një takim me Komandantin e
24 NATO-s Wesley Clark të cilit i përshkroi situatën në Kosovë.
25 Në këto takime të nivelit të lartë Kryeministri i Kosovës

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 79

1 kërkoj vazhdimësinë dhe intensifikimin e sulmeve të NATO-s mbi
2 aktivitetet ushtarake serbe në Kosovë”.

3 Gjeneral, a është e mundur që takimi që ju kujtohet juve
4 në prill në fakt është takimi i 29 majit, që e lexoni këtu. A
5 është e mundur kjo gjë?

6 PË. Unë nuk mendoj se e kam thënë gabim, nuk e di në qoftë se
7 mund ta kontrolloj apo jo.

8 PY. Besoj që mund të vazhdojmë më tej. Atëherë, i takon që
9 mbështetur në atë çfarë po thoni, ju nuk kujtoheni --

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Kjo është një pyetje të cilën iu
11 përgjigj dëshmitari.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk pranohet
13 kundërshtimi.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Atëherë, pyetja është kjo: Juve
15 nuk ju kujtohet në qoftë se jeni takuar me Hashim Thaçi një
16 herë ose dy herë gjatë bombardimeve, apo jo?

17 PË. Kjo është e saktë. Megjithatë, nuk mora një përgjigje me
18 faktin në qoftë se unë mund të kontrolloja materialet për të
19 identifikuar datën e takimit.

20 PY. Dua që të përqendrohemi tani te takimi ku keni kërkuar
21 ndihmën e Hashim Thaçi për identifikimin e objektivave për
22 sulmet ajrore. Ju thatë sot se ju nuk kishit marrëdhënie të
23 drejtpërdrejta me UÇK-në. Gjithashtu, ju thatë që NATO-ja po
24 mendohej që të mblidhte informacion për objektivat nga UÇK-ja.

25 Pse do e kërkonit ju ndihmën e Hashim Thaçit për sa i takon

1 objektivave?

2 PË. Jam përpjekur që ta shpjegoj këtë sa i takon fushatës
3 ajrore dhe jam përpjekur t'ju them, t'ju shpjegoj që procesi
4 ka qenë një proces dinamik nga fillimi në fund. Kur filloi ne
5 kishim një listë të objektivave që ekzistonin në Kosovë. Këto
6 ishin objektiva të fiksuara dhe në thelb ishin bunkerë për
7 ruajtjen e municioneve ose ishin godina, ndërtesa të ushtrisë
8 serbe. Dhe ne e dinim që bëhej fjalë për një sulm simbolik
9 sepse këto godina ishin të boshatisura.

10 Kështu që pyetja që shtrohet ishte në qoftë se ne do të
11 vazhdonim më tej me kufizimet, në qoftë se do të vazhdonim me
12 vëzhgime satelitore, dhe transmetimin e të dhënave në vitin
13 1999. Dhe kemi pasur një listë shumë të kufizuar të
14 objektivave përpara fushatës. Kemi pasur pak a shumë 200
15 objektiva mbase, dhe ato ishin, nuk ishin objektiva të mirë,
16 nuk ishin objektiva që do konsideroheshin vendimtare kundër
17 qeverisë në Beograd.

18 Kam pasur një bisedë me Javier Solana lidhur me këtë
19 pikë. Komandanti im ushtarak më tha, "Ne duam që të godasim
20 menjëherë Beogradin dhe të fikim dritat, ashtu siç kemi bërë
21 në Bagdad. Domethënë, Javier Solana dhe unë diskutuam që kjo
22 nuk do të ishte e mundur. Shtetet e Bashkuara kanë qenë
23 përgjegjëse për targetimin ose për shënjestrimin, për
24 objektivat, dhe ky ishte një ndër përparësitë kryesore kundër
25 Koresë së Veriut, Irakut, Iranit, domethënë, kjo ka qenë një

1 metodologji të cilën ne e kemi përdorur dhe në vende të tjera.

2 Ne, për të luftuar ose për të sulmuar forcat serbe,
3 kishim nevojë për informacion në kohë reale, na duheshin
4 gjithashtu burime të shumta informacioni, si për shembull
5 informacioni që e merrnim përmes përgjimeve telefonike, ose na
6 duhen gjithashtu edhe informacion që e merrnim nga dronë.
7 Sepse ndonjëherë i merrnim imazhet, por nuk e dinim se çfarë
8 shikonim nëpër ekran.

9 Ne e kuptuam që kishim një deficit të madh informacioni
10 dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së fushatës ne, në mënyrë të
11 vazhdueshme, jemi përpjekur që t'i gjejmë zgjidhje kësaj
12 situate, ose këtij problemi. Dhe për këtë arsye u takova me
13 Thaçin. Mendoj që për këtë arsye jam takuar përsëri me të në
14 prill në zyrat e mia. Nuk bëhet fjalë për këtë takim,
15 domethënë, ky është një takim që mbase ka ndodhur, me shumë
16 gjasa ka ndodhur, por nuk është se më ka lënë ndonjë
17 përshtypje. Por, siç ju thashë, u takova me të, por përgjigjja
18 nuk ishte e suksesshme.

19 PY. Faleminderit, Gjeneral. Ju në këtë kohë e dinit që z.
20 Thaçi ishte i përqendruar te kontaktimi me ndërkombëtarët, apo
21 jo?

22 PË. E drejtë. Nuk është se e dija këtë gjë, por ai ishte e
23 vetmja pikëlidhje që kishim ne.

24 PY. Në paragrafin 22 të deklaratës kur flisni për takimin në
25 mes të marsit të 1999, ju thatë:

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 82

1 "Vëmendja e Thaçit ishte të kontaktonte me ndërkombëtarët
2 në Zvicër dhe në Shtetet e Bashkuara".

3 Dëshmitar, pra ju e dinit në atë kohë që Thaçi e kishte
4 vëmendjen te kontaktimi me ndërkombëtarët, apo jo?

5 PË. Po.

6 PY. Duke marrë parasysh elementin e kohës dhe që koha ishte
7 shumë e rëndësishme sa i takon objektivave, pse prisnit ju që
8 ju të dinit informacionet më të fundit për pozicionet e
9 serbëve nga UÇK-ja?

10 PË. Ky informacion ishte i rëndësishëm për ne, për të krijuar
11 një sistem, por edhe herën e dytë kur u takua, kur erdhi tek
12 ne, ai ende nuk dinte asgjë.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Tani dua që të shohim një video,
14 transkriptin e së cilës ne e pamë pak më herët. Për
15 procesverbal është dokumenti 128928-03_2. Do kërkoja që të
16 paraqitet në ekran transkripti shoqërues që mban numrin
17 128928-03-TR-AT-ET, faqja 2.

18 PY. Që në fillim dua t'ju kërkoj ndjesë, Gjeneral, sepse
19 bëhet fjalë për një intervistë që keni dhënë për televizionin
20 shqiptar në gusht 2000. Ju keni folur në anglisht në këtë
21 intervistë. Më pas përgjigjet tuaja janë të shkruara me tituj
22 në fund të regjistrimi.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Për orientim të dëshmitarit,
24 dëshmia është dhënë në vitin 2020, jo në vitin 2000.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, e thashë gabim.

1 Është intervistë që është dhënë më datë 1 gusht 2020.

2 Është dhënë për RTK-në. Do shikojmë faqen 2 të
3 transkriptit dhe do kërkoja që të na paraqitet tani videoja në
4 pjesën e dytë të saj, duke filluar nga 02:34 deri 03:41.

5 PY. Sikurse do e shihni, pjesa që do paraqitet në ekran do
6 përfundojë me transkriptin që keni përsëri përpara, Dëshmitar.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Videoja, pra kjo është videoja --
8 atëherë nga 02:34 deri 03:41.

9 [Luhet videoincizimi]

10 "Komandantët tanë atje kanë bërë gjithçka në ndihmë të
11 kosovarëve si dhe administratës së OKB-së, përfshirë edhe
12 liderët që dolën në atë kohë duke përfshirë këtu edhe z.
13 Thaçi. E mbaj mend dhe Presidentin Rugova, z. Haradinaj dhe të
14 tjerët. Pra, jemi përpjekur jo vetëm të rikthejmë normalen,
15 por edhe të mbronim monumentet serbe, manastiret, familjet
16 individuale serbe, gjithçka në përpjekje për të tejkaluar atë
17 periudhë të tmerrshme e të dhimbshme që Kosova kishte
18 përjetuar. Presidenti, atëherë, z. Hashim Thaçi, ishte
19 zëdhënës i UÇK-së. Me të jam takuar një herë shkurt jashtë
20 selisë së NATO-s në Belgjikë. Ai më pati thënë që janë duke
21 mbijetuar, që po bënin atë që munden. Thashë që është mirë, ne
22 duam që t'ju ndihmojmë. Megjithatë, NATO-ja nuk ka pasur
23 marrëdhënie të drejtpërdrejta me UÇK-në, thjesht nuk kemi
24 marrë raporte nga ata si dhe nuk kemi pasur se si ta dimë se
25 çfarë po ndodhte.

1 "Më shumë se njëzet vjet --"

2 Z. HALLING: [Përkthim] Mund ta ndaloni videon këtu.

3 PY. Gjeneral, ju thoni këtu që jeni takuar me z. Thaçi një
4 herë shkurt në Shtabin, jashtë Shtabit të NATO-s në Belgjikë.
5 Për këtë takim e keni fjalën kur flisni për objektivat?

6 PË. Kam përshtypjen që i referohem kohës kur ka ardhur në
7 fushë ajrore.

8 PY. A ka ndonjë informacion tjetër, a ka ndonjë tjetër burim
9 informacioni që pranon publikisht që ju jeni takuar me Hashim
10 Thaçin, Dëshmitar?

11 PË. Nuk e di në qoftë se ekziston ndonjë deklaratë tjetër,
12 por në qoftë se do të ketë ekzistuar një deklaratë e tillë,
13 besoj do ta keni gjetur.

14 PY. Sikurse e diskutuam më herët, kjo ju bën juve që të
15 vazhdoni të thoni që NATO-ja nuk ka pasur komunikim të
16 vazhdueshëm me UÇK-në. Dhe unë ju them që ky komenti juaj ka
17 kuptim vetëm në qoftë se takimi midis jush dhe Hashim Thaçit
18 nuk ka qenë në lidhje me objektivat.

19 PË. Nuk e kuptoj çfarë pyetjeje keni për mua.

20 PY. A pajtoheni me këtë propozim timin apo jo?

21 PË. Ka dy çështje fakti, që ndoshta janë kontradiktore,
22 kundërshtuese të njëra-tjetrës. Atëherë, titulli i raportit
23 ishte një fushatë e çorganizuar, dhe kjo ishte përvoja ime e
24 parë, pra që shikoja një operacion të aleancës dhe ndoshta
25 operacioni mund të dukej i çorientuar. E kam fjalën këtu për

1 raportet e Randit. Dhe qasja e dytë ishte që kombet e NATO-s
2 thonin, ose Klaus Naumann thoshte që nuk donte që të kishte
3 marrëdhënie me UÇK-në.

4 Çdo gjë ishte dinamike, gjërat ndryshonin. Çfarë dua të
5 them me këtë? Për ta ilustruar më lejoni të them si më poshtë:
6 kur filluan bombardimet, pyetjet që na bëheshin ishin: sa do
7 zgjasin fushatat bombarduese? Ca kombe, francezët, spanjollët,
8 pra, më thonin që pasi të fillojnë bombardimet e NATO-s
9 Milosheviqi patjetër do të dorëzohet. Por kush e dinte me
10 siguri këtë gjë? Unë nuk po thoja që kjo ndoshta nuk do të
11 ishte e vërtetë. Unë shpresoja që të ishte e vërtetë dhe
12 shpresoja që çdo gjë të zgjidhej brenda një dite. Por në fakt,
13 mëngjesin pasi bëmë goditjen e parë, e kam marrë në telefon
14 Gjeneralin Ojdanic dhe i thashë, "Tani ne bëmë goditjet tona.
15 I filluam bombardimet, dhe mendoj që ka ardhur koha tanimë që
16 të tërhiqni forcat, dhe të bëni pjesën tuaj për atë që keni
17 rënë dakord".

18 Pra, qëllimi tanimë nuk ishte që të bënim ose të bindnim
19 serbët që të tërhiqnin forcat e tyre nga Kosova. Domethënë,
20 qëllimi ishte që ata ta merrnin mesazhin, se situata ishte
21 tërësisht e ndryshme nga ajo çfarë kishte qenë në Bosnjë. Pra,
22 situata ishte e ndryshueshme nga momenti në moment, dhe e kam
23 thënë në fakt edhe në konferencën që e kam dhënë për shtyp, që
24 e kam dhënë pa udhëzimet e Pentagonit, megjithëse kërkoja që
25 Pentagoni të më jepte udhëzimet. Kam përshtypjen që më datën

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 86

1 25 në mëngjes, me Solana, kam thënë që ne do sulmojmë, do
2 shkatërrojmë ato elementë të cilët, ato elementë që
3 Milosheviqi i vlerëson më tepër.

4 PY. Gjeneral, po shkon përtej asaj që po të pyes. Unë po flas
5 lidhur me takimin që keni pasur ju me Hashim Thaçi.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Për këtë do i kërkoja Sekretarit
7 që të paraqesë në ekran P524.

8 PY. E kuptoj që nuk ju kujtohen të gjitha përgjigjet.

9 PË. Duhet ta kuptosh që situata ishte një situatë që
10 drejtohej nga planifikimi politik, nuk është se ishte një
11 planifikim i mirë ushtarak. Po të kishte qenë një plan
12 ushtarak i mirëfilltë, do e kishim ndjekur këtë plan nga
13 fillimi deri në fund. Por ajo çfarë bëmë neve është që ne kemi
14 luftuar në të gjitha frontet në të gjitha linjat e mundshme në
15 mënyrë të tillë që të rrisnim presionin, trysninë mbi
16 Milosheviqin.

17 Z. HALLING: [Përkthim] Të shohim dokumentin që është në
18 ekran.

19 PY. E kuptoj që mbase ju nuk kujtohet plotësisht se kur keni
20 pasur diskutim me Hashim Thaçin për objektivat. Por mund të
21 ketë ndodhur më 25 maj, apo jo?

22 PË. Po, mund të ketë ndodhur.

23 PY. Kjo është intervista me Hashim Thaçin në këtë datë. Në
24 fund të kësaj faqeje bëhet kjo pyetje për Hashim Thaçin:

25 "A e është e vërtetë që UÇK-ja e ka ndihmuar NATO-n që të

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 87

1 lokalizojë objektivat brenda Kosovës?"

2 Përgjigjja që jep Thaçi është kjo:

3 "Është e mundur, por unë mendoj që NATO-ja e ka
4 informacionin që i nevojitet".

5 Si mund të japë Hashim Thaçi një përgjigje të tillë nëse
6 ju do e keni pyetur atë më herët për objektivat?

7 PË. Mund ta ketë dhënë një përgjigje të tillë se nuk e ka
8 pasur informacionin.

9 PY. Pyetja ishte kjo, Dëshmitar:

10 "A është e vërtetë që UÇK-ja e ka ndihmuar NATO-n për të
11 lokalizuar objektivat brenda Kosovës?"

12 Dhe ai thotë:

13 "Është e mundur ...".

14 Tani pyetja që kam për juve është kjo: Si mund ta ketë
15 dhënë këtë informacion në qoftë se diskutimi që ka pasur me
16 juve ka pasur të bënte me objektivat?

17 PË. Ne kemi pasur një bisedë lidhur me objektivat, dhe ai nuk
18 ishte në gjendje që të më jepte ndihmën e tij për
19 identifikimin e objektivave. Unë udhëzova Komandën time që të
20 merrte sa më shumë informacione që të ishte e mundur, sa më
21 shumë informacione që ishte komunikuar përfshirë këtu edhe
22 përmes qeverisë shqiptare dhe për të marrë informacione si në
23 mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë.

24 Dhe përfundimi im ishte që Hashim Thaçi nuk është se
25 ishte i lidhur mirë me këtë pikë.

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 88

1 PY. Tani --

2 Z. HALLING: [Përkthim] Të shikojmë dokumentin që keni në
3 ekran.

4 PY. Dëshiroj që të përqendrohemi tani tek takimi që keni
5 diskutuar dje me Hashim Thaçin dhe komandantët e zonave
6 përpara përfundimit të periudhës së demilitarizimit. A është
7 ky takimi i vetëm me të cilët ju jeni takuar si me Hashim
8 Thaçin dhe me komandantët e zonave në të njëjtin vend?
9 Atëherë, me sa ju kujtohet.

10 PË. Me sa më kujtohet mua, mundësisht jo, do thoja. Sepse kur
11 u ktheva, kur u ulëm me Mike Jackson dhe filluam të punonim
12 marrëveshjen, unë me sa më kujtohet, i kisha parë këta persona
13 edhe më herët.

14 PY. Po e thatë edhe dje që i kishit parë ato persona më
15 përpara, por nuk ju kujtohej se kush ishin këta persona apo
16 jo?

17 PË. Jo. Unë nuk është se kisha kartat, nuk është se e dija se
18 si shqiptoheshin emrat e tyre, nuk ia dija emrat, por ata
19 thjesht po prezantoheshin. Kështu që, në të gjitha ato
20 zhvillime ishte shumë e vështirë që të kujtoja emrat e persona
21 të dija ekzaktësisht se kush ishte kush.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Tani do kërkoj që të paraqitet
23 prova P04501.

24 PY. Dje, dhe kjo për referencë kjo jepet në faqet e
25 transkriptit të kohës reale faqja 49 deri në 50. Ju treguan

1 një libër të Gjeneralit Jackson, jua tregoi këtë Mbrojtja e
2 Thaçit, edhe kjo pjesë flet për përfshirjen tuaj në këtë takim
3 me komandantët e zonave. Pra, Jackson po flet pak momente
4 përpara se sa ju të bëheshit pjesë e takimit. Dhe këtu thuhet:

5 "Negociatat u bënë shumë të tensionuara."

6 Përpara se sa ju të mbërrinit në takim.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Të vazhdojmë tek faqja tjetër.

8 PY. Jackson më tej thotë që:

9 "Ne mbërritëm D+89. Ndërkohë që Thaçi na tha i inatosur,
10 'Askush nuk luan lojëra me UÇK-në', ai na bërtiti duke thënë
11 këtë gjë. 'Në qoftë se ju mendoni që mund të na jepni ne
12 udhëzime, atëherë e keni gabim dhe do ju vijë keq për këtë.'"

13 A keni qenë i informuar për këtë, Dëshmitar?

14 PË. Me shumë gjasa, po. Kam përshtypjen që Jackson do ma ketë
15 thënë.

16 PY. Keni folur në paragrafin 31 të deklaratës së pranuar në
17 prova, lidhur me mungesën e ndikimit që kishte Hashim Thaçi
18 mbi ushtarët e UÇK-së, dhe keni -- kjo është përforcuar
19 gjithashtu edhe në këtë takim, apo jo?

20 PË. Po.

21 PY. Por, kjo ka ndodhur pas kësaj, këtij shkëmbimi, a nuk
22 është e vërtetë që Hashim Thaçi ka pasur kompetencë politike
23 që ka qenë e ndryshme nga kompetenca ose autoriteti i
24 ushtarëve me të cilët ai fliste?

25 PË. Duket sikur është kështu. Por, nga ana tjetër, sikur janë

1 përpjekur ta shpjegoj dhe më përpara dhe sikurse thotë Mike
2 Jackson këtu, ky ishte një proces. Nuk mund ta shikoje të
3 fragmentarizuar. Pra, flitej për një organizatë rezistence që
4 kishte mbështetje të NATO-s edhe ndjesia ishte që Serbia do
5 dëbohej. Dhe ajo çfarë thoshte NATO-ja këtu ishte që, kini
6 parasysh një gjë, që ju duhet të çarmatoseni dhe nga ana
7 tjetër duhet që të largoheni.

8 Dhe në momentin kur unë u ktheva, pra, unë u mundova që
9 të siguroja që nuk duhet të kishte një asociim ushtarak më,
10 pas ndërhyrjes. Dhe ndërkohë, ajo për të cilën po flasim këtu,
11 janë thjesht hollësitë se si janë zhvilluar këto hollësitë.
12 Sigurisht që ka pasur shumë inate, sigurisht që ka pasur shumë
13 fërkime, dhe sigurisht që janë bërë shumë deklarata që janë
14 shprehur.

15 PY. Është e vërtetë, apo jo, që një pjesë kryesore e
16 komenteve të zonave, të komandantëve të zonave, qëllimi i tyre
17 ishte që të theksohej se si ushtria duhet të jetë subjekt i
18 autoritetit civil?

19 PË. Po.

20 PY. Në karrierën tuaj ushtarake, ju keni qenë i varur nga
21 Presidenti i Shteteve të Bashkuara, që ishte Komandanti
22 Kryesor i Forcave të Armatosura, apo jo?

23 PË. Po, dhe nga Sekretarja ose Sekretari i Mbrojtjes.

24 PY. A dini në qoftë se UÇK-ja ka identifikuar ndokënd si
25 komandantin e vet?

1 PË. Jo, jo në dijeni në time. Nuk e kam menduar këtë në asnjë
2 moment. Edhe mënyra se si e kam parë unë ngjarjet, është që
3 Çeku ka qenë personi përgjegjës.

4 PY. Këto nënkuptime që keni bërë në të gjitha provat tuaja,
5 në të gjithë dëshminë tuaj, sa i takon autoritetit, komandës,
6 ndikimet, të gjitha kanë çuar në përfundimin e dhënë në
7 paragrafin 52 të deklaratës që ju nuk besoni që do ishte e
8 drejtë që t'i atribuohet sjellje të të tjerëve Hashim Thaçit.
9 Këtë keni thënë, apo jo?

10 PË. Po.

11 PY. Unë po ju parashtroj qëndrimin tim, që ju nuk dini
12 mjaftueshëm lidhur me UÇK-në dhe lidhur me atë çfarë UÇK-ja ka
13 bërë gjatë gjithë luftës për të ditur në qoftë se akuzat me të
14 cilat përballet z. Thaçi në këtë Gjykatë janë të qenësishme
15 apo jo. Çfarë përgjigje keni ju për këtë qëndrim tonin?

16 PË. Kjo është një akuzë që është vetëm pjesërisht relevante
17 për proceset e kësaj Gjykate, sepse si komandant strategjik,
18 jo, asnjëherë nuk kemi pasur mundësinë që të bëjmë kërkime dhe
19 që të na vërtetohet ky qëndrim. Thaçi thjesht rezultoi që të
20 ishte personi, person ambicion, person i artikuluar, i
21 prezantueshëm.

22 Por për sa i takon kontrollit, padiskutim që nuk ka pasur
23 kontroll. Absolutisht nuk e kam parë një gjë të tillë sepse
24 këto elementë nuk kishin atë lloj strukture që do të kishte
25 një organizatë normale. Bëhej fjalë për persona, grupe

1 individuale që thjesht po luftonin për mbijetesën e tyre. Nuk
2 ekzistonte asnjë lloj letre ku shkruheshin gjërat. Për
3 shembull, në qoftë se do shikojmë shembuj historikë edhe besoj
4 që shembulli më i mirë është shembulli i revolucionit
5 amerikan.

6 PY. Gjeneral, nuk po flasim për revolucionin amerikan këtu.
7 Nuk po flasim për asgjë tjetër, por përveç faktit në qoftë se
8 ju e dini apo jo që akuzat ndaj të cilat përballet ai janë të
9 qenësishme apo jo.

10 PË. Jo, akuzat nuk janë të qenësishme.

11 PY. Faleminderit.

12 Z. HALLING: [Përkthim] Tani le të kalojmë tek videoja që
13 e tregova pak më herët. Do i lutesha Sekretarit të parqesë në
14 ekran dokumentin përkatës 128928-03_2 me numër ERN-je 128928-
15 03-TR-AT-ET, faqja 1. Atëherë, do ju kërkoja që të
16 transmetohet dokumenti nga 00:22 deri në 01:34 [Sipas
17 përkthimit].

18 [Luhet videoincizimi]

19 Z. HALLING: [Përkthim]

20 PY. Atëherë i jam mirënjohës avokatit për korrigjimin që na
21 bëri më përpara, sepse data e intervistës është domethënëse.
22 Data 1 gusht 2020 ka qenë pak më tepër se sa një muaj pas
23 bërjes publike të aktakuzës së kësaj çështjeje gjyqësore. Në
24 pjesën që do dëgjojmë tani në video, ju do dëgjoni atë çfarë
25 keni thënë në përgjigje.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Është keqinterperetim, nuk është e
2 saktë që aktakuza është bërë publike në atë datë.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, njoftimi është lëshuar
4 atëherë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Në fakt nuk mendoj që përshkrimi
7 që bëri Prokurori është i saktë, nuk është bërë njoftimi i
8 aktakuzës në datën që pretendon ai.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Unë, po të duash, të bëj të ditur
10 njoftimin për shtyp që ka qenë më datë 24 qershor 2020. Dhe
11 kjo është baza e pyetjeve të mia.

12 Do i kërkoja Sekretarit tani që të na japë videon, koha
13 që e specifikova më lart.

14 [Luhet videoincizimi]

15 "E vërteta është që presioni ndaj Kosovës si dhe
16 përpjekjet e ndryshme për të nënçmuar Kosovën, nuk janë ndalur
17 kurrë. Që nga koha kur rusët kishin marrë aeroportin e
18 Prishtinës, që prej asaj mësymjeje kur kishin uzurpuar një
19 sektor të vetit diku nga ana lindore e Kosovës, e deri te
20 obstruksionet diplomatike. Nuk ka pasur kurrë ndalesë të
21 përpjekjeve për të vënë pengesa në rrugën e Kosovës drejt
22 përparimit. Pra, është krejtësisht normale të priten përpjekje
23 të tilla që të bëhen përmes kanaleve të ndryshme. Tani sa i
24 përket përmbajtjes së këtyre akuzave, nëse ato qëndrojnë apo
25 jo, nuk e kam idenë. Shihet megjithatë një lloj vazhdimësie e

1 aktiviteteteve që është mjaft e dukshme edhe 20 vjet më pas".

2 "Njeriu që udhëhoqi operacionin --"

3 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit. Mund të ndaloni
4 këtu.

5 PY. Besoj e dëgjuat që atë çfarë keni thënë për këtë Gjykatë
6 dhe këto akuza. Në 2020 ju thatë që nuk e keni idenë fare në
7 qoftë se këto akuza ndaj Hashim Thaçit qëndrojnë apo jo. Dhe
8 edhe sot e kësaj dite këtë qëndrim keni, apo jo, Dëshmitar?

9 PË. Në fakt, kur e kam bërë këtë deklaratë nuk e dija se
10 cilat ishin akuzat. Akuzat për të cilat mendoja unë kishin në
11 mendjen time, të paktën, kisha shitje organesh. Kam
12 përshtypjen që në periudhën 2007 ose 2008 kishte akuza ndaj
13 UÇK-së për shitje organesh. Dhe unë personalisht atë e
14 konsideroja thjesht dezinformim.

15 Nuk më kujtohet se kur e kam kuptuar plotësisht se për
16 çfarë bënin fjalë akuzat, por jam shumë i sigurt që në
17 momentin kur kam dhënë këtë deklaratë, unë nuk e kisha idenë
18 se cilat ishin akuzat e ngritura. Pra, nuk më kujtohej që t'i
19 kemi lexuar, në fakt, plotësisht akuzat përpara një nate.

20 PY. Domethënë, përpara një nate, deri dje domethënë, nuk
21 është se jeni informuar konkretisht për akuzat, për aktakuzën
22 ose për dosjet para gjyqësore, apo jo?

23 PË. Po. Nuk kam marrë asnjë informacion nga Mike Durkee, nga
24 John Duncan, dhe me thënë të drejtën nuk e dija se sa kërkime,
25 sa lexime duhej të bëja në mënyrë të tillë që të kisha mundësi

1 që t'u përgjigjesha siç duhej pyetjeve tuaja.

2 PY. Faleminderit, Gjeneral.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Duam, të nderuar Gjykatës, që për
4 momentin, të kërkoj pranimin e kësaj videoje dhe transkriptit
5 shoqërues, me numrat ERN që përmenda më sipër.

6 PY. Gjeneral, nuk kam më pyetje të tjera për ju.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka pyetje,
8 a ka kundërshtim për pranimin e dokumentit?

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë,
11 dokumenti me ERN 128928-03-TR-AT pranohet.

12 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Këtij dokumenti i
13 caktohet prova P04522. Dhe aktualisht klasifikohet si
14 konfidencial.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Mund të klasifikohet si publik dhe
16 duhet që të pranohen versioni në shqip dhe në anglisht,
17 përkthimi përkatës.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përfshihen
19 edhe përkthimet përkatëse dhe riklasifikimi është publik.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit të nderuar Gjykatës,
21 faleminderit, Dëshmitar.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A keni pyetje
23 plotësuese?

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, kemi.

25 Pyetje vijuese nga z. Misetic:

1 Z. MISETIC: [Përkthim]

2 PY. Dëshmitar, meqë e kemi dokumentin në ekran besoj se e
3 vutë re se në këtë moment në gusht ende nuk ishte e qartë se
4 me çfarë akuzash po përballeshin të akuzuarit?

5 PË. Po.

6 PY. Ju thatë se kishit dëgjuar që akuzat të lidheshin me
7 trafikimin e organeve?

8 PË. Po.

9 PY. Atëherë, mund të na tregoni çfarë kishit dëgjuar ju për
10 këtë lëndë gjyqësore në gusht për trafikim organesh?

11 PË. Unë mendova se dikush në fakt kishte prova konkrete për
12 këtë akuzë.

13 PY. Dhe ju thatë që trafikimi i organeve në fakt ishte një
14 fushatë dezinformimi, në të vërtetë.

15 PË. Po.

16 PY. Atëherë, pse mendoni ju se çështja e trafikimit të
17 organeve ishte një fushatë dezinformimi?

18 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtoj, nuk është relevante.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Po ju, për këtë diskutuat.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet,
21 vazhdoni.

22 DËSHMITARI: [Përkthim] Mendoj se ishte propozim qesharak,
23 që në një fushatë ajrore bombardimesh hiqeshin organet e
24 njerëzve dhe shiteshin. S'ka kuptim, nuk kishte kuptim kjo
25 gjë. Ishte thjesht dezinformim.

1 Z. MISETIC: [Përkthim]

2 PY. Kush mendoni se e kishte nisur këtë fushatë dezinformimi?

3 PË. Të njëjtat persona që më dhanë librin në vjeshtën e 1998-
4 s.

5 PY. Kush ishin këta?

6 PË. Këta ishin rusët.

7 PY. Dua të filloj me disa pyetje për kuriozitetin tim,
8 thjesht për të më ndihmuar mua. Ju keni qenë Komandanti Suprem
9 i Forcave Aleate në Evropë. Akronimi është shqiptuar në forma
10 të ndryshme, ju lutem na ndihmoni, si shqiptohet?

11 PË. SACEUR.

12 PY. SACEUR. Në rregull.

13 Të fillojmë me këtë pyetje: Përfundimi i kundërpyetjeve
14 ishte kështu, ku e bazoni ju përfundimet tuaja kur thoni që z.
15 Thaçi nuk mban përgjegjësi për veprimet e të tjerëve?
16 Prokuroria ju bëri pyetje për rreth katër orë.

17 A keni parë ndonjë urdhër nga z. Thaçi drejtuar ndonjë
18 personi ju?

19 PË. Jo.

20 PY. Prokurori a ju tregoi ndonjë raport të lëshuar nga ndonjë
21 vartës drejtuar z. Thaçi?

22 PË. Jo.

23 PY. A keni parë ndonjë dokument nga ana e Prokurorit gjatë
24 kundërpyetjeve që ju shtyn të mendoni që në fakt z. Thaçi mund
25 të ketë qenë komandant ushtarak?

1 PË. Jo.

2 PY. Ndonjë nga dokumentet që ju tregoi Prokuroria gjatë
3 kundërpjetjeve a ju vuri në pikëpyetjet përfundimet tuaja sa i
4 takon përgjegjësisë penale të z. Thaçi për veprime të të
5 tjerëve?

6 PË. Jo.

7 PY. Faleminderit. Përmendët dy persona tani, John Duncan dhe
8 Mike Durkee. A ju raportnin ju?

9 PË. Po.

10 PY. Nëse ata do të takonin komandantët e zonave në terren, a
11 do t'ua raportnin këtë gjë ju?

12 PË. Nëse do t'i takonin gjatë konfliktit, po, do më raportin.

13 PY. Po e korrigoj. Po korrigoj atë që thashë. Pas 1244

14 Rezolutës, nëse do të shkonin në Kosovë ata të takonin
15 komandantët e zonave, a do ua raportnin juve diçka të tillë?

16 PË. Po, për mua s'do ishte informacion me rëndësi sepse ata
17 ishin vartës dhe kishin përgjegjësitë e tyre. Po për
18 komandantët e zonave apo çfarëdolloj titujsh që kishin këta
19 persona për mua nuk ishte relevante për nivelin tim të
20 drejtimit.

21 PY. Përshtypjet që krijonin ata për terrenin a t'i përcillnin
22 ty?

23 PË. Po.

24 PY. Dhe më pas a dilnit ju në përfundimet tuaja në bazë të
25 informacioneve që ju jepnit vartësit tuaj mes të cilëve John

1 Duncan dhe Mike Durkee?

2 PË. Po.

3 PY. Ju bëri disa pyetje Prokurori dhe madje u përpoq që ju të
4 bënit një krahasim sa i takon komandës dhe kontrollit, pra,
5 nëse Mike Jackson në të vërtetë mund të shpërfillte urdhrat
6 tuaj sepse kështu funksionojnë ndonjëherë gjërat në komandë,
7 kështu. A ju kujtohet kjo pyetje?

8 PË. Po. Faleminderit që e thatë këtë gjë se dua të komentoj.

9 PY. Do ju jap plotë mundësi të na tregoni dallimin mes këtyre
10 të dyja gjërave.

11 Por unë dua të them këtë fillimisht, të krahasojmë
12 njëherë, po krahasojmë mollën me mollën apo mollën me
13 portokallin. Fillojmë kështu.

14 Në Ushtrinë e Amerikës, nëse Gjeneral me katër yje, si
15 ju, i lëshon një urdhër një vartësi dhe ai thotë, Gjeneral
16 Clark nuk kam dëshirë ta zbatoj urdhrin tuaj, çfarë masash
17 merrni ju?

18 PË. Fillimisht do ta pyesja pse. Më lejoni t'ju shpjegoj
19 diçka.

20 Në sistemin sovjetik të ushtrisë, nëse jepej urdhër dhe
21 nuk e zbatoje, quheshe tradhtar dhe po saboton një operacion.
22 Kështu funksiononte doktrina sovjetike. Amerika e ka ndryshe.
23 Kur japim urdhër për një operacion i kalon vartësit, vartësi e
24 analizon dhe mund të thotë që "Unë nuk mund ta zbatoj këtë
25 urdhër. Më duhet më shumë informacion. Nuk mund ta kaloj lumin

1 vetëm. Më duhen ura, më duhen inxhinierë". Në sistemin
2 sovjetik quhet sabotim konsiderohej sabotim i planit të
3 selisë. Në sistemin amerikan ne kemi një frymë bashkëpunimi.

4 Dhe ky është fakt. Pra, okej po ndaloj. Ma bëni pyetjen.

5 PY. Jemi në skenar tjetër, në një situatë tjetër, i ke
6 dëgjuar argumentet dhe keni dalë në një vendim përfundimtar,
7 bashkëpunuat por ju vendosni ama. Dhe prapë vartësi të thotë
8 nuk do ta respektoj urdhrin tuaj?

9 PË. Atëherë ky person duhet të largohet nga komanda si
10 rregull.

11 PY. Kjo ndodh në sistemin amerikan.

12 Por në një situatë në NATO-s dhe konkretisht me KFOR-in,
13 cili ishte plani operacional dhe mund të na thoni nëse secili
14 shtet përmes kontingjenteve të tyre kishte ndonjë lloj
15 kompetence?

16 PË. Po flasim për KFOR-in pas përfundimit të fushatës ajrore?

17 PY. Po.

18 PË. Brenda NATO-s komandën e ka shteti përkatës i atij
19 kontingjenti. Disiplina, heqja nga detyra, rritja në detyrë.
20 Operacioni dhe kontrolli është i NATO-s. Por nëse komandanti i
21 shtetit përkatës e kundërshton urdhrin e NATO-s ky person ka
22 të drejtë t'i drejtohet komandantit të vet në shtetin e vet.

23 PY. Më kritikuan se po flas shumë shpejt, do të duhet
24 patjetër që të bëj një pauzë. Ju bëri pyetje Prokurori për
25 Gjeneralin Mike Jackson, pistën ajrore në Prishtinë dhe kështu

1 me radhë.

2 A e kuptova unë drejt përgjigjen tuaj, kur thatë që në
3 kontekstin e NATO-s, Gjeneral Jackson kishte të drejtë të
4 komandonte komandantin e vet për këtë aspekt?

5 PË. Për çdo aspekt.

6 PY. Ta sqarojmë, e kam fjalën që ai mund t'u drejtohej
7 britanikëve?

8 PË. Po, po. Mund t'ju drejtohej britanikëve për këtë aspekte.
9 Dhe unë kisha të drejtën time ta kundërshtoja. Po unë nuk mund
10 të merrja masa disiplinore për të as nuk mund ta shkarkoja nga
11 detyra. Ishte thjesht çështje gjykimi profesionist ushtarak.

12 PY. Kur flasim për komandën dhe kontrollin brenda një ushtrie
13 kombëtare, jo forcë shumëkombëshe, a është e nevojshme të kesh
14 një strukturë komande dhe kontrolli efektive në mënyrë që
15 eprori përkatës, komandanti të ketë mundësi ta shkarkojë një
16 komandant nëse nuk e zbaton një urdhër?

17 PË. Nëse do të kishim një strukturë të mirëfilltë të tillë,
18 po, kështu duhet të kishte ndodhur.

19 Por tani dua të them diçka. Dua ta bëj të qartë,
20 zakonisht duhet kuptuar eprori drejtpërdrejt. Duhet parë cilat
21 janë hallkat në zinxhirin hierarkik, duhet kuptuar ky
22 kontekst.

23 PY. Në rregull. Ju bënë pyetje për informacionin e përpunuar,
24 informacionin e inteligjencës dhe sesi morët informacion të
25 gabuar.

1 PË. Po.

2 PY. Përfundimet tuaja për Kosovën ishin bazuar në
3 informacionin e përpunuar që merrnit?

4 PË. Po.

5 PY. Ai ishin bazuar po ashtu në udhëtimet që kishit pasur ju
6 personalisht në Kosovë?

7 PË. Po.

8 PY. Në deklaratën tuaj thoni se ishit bazuar gjithashtu në
9 takimin që keni qenë në shtator me z. Thaçi dhe komandantët e
10 zonave, apo jo?

11 PË. Po.

12 PY. A mos janë bazuar vallë dhe mbi konstatimet e z. Durkee
13 dhe z. Duncan?

14 PË. Po.

15 PY. Gjenerali Jackson ju informonte për ato ç'ka shihte?

16 PË. Po.

17 PY. Gjeneral Jackson a ju ka informuar ndonjëherë që se ai
18 donte se komandantët e zonave të ishin të pranishëm në takimet
19 e KPI-së?

20 PË. Nuk më kujtohet konkretisht diçka e tillë, një deklaratë
21 e këtij lloji?

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim në ekran provën materiale
23 P02516.

24 PY. Ju janë bërë disa pyetje për mundësinë e rifillimit të
25 luftimeve me Serbinë dhe unë dua t'ju pyes nëse ju ka

1 raportuar Gjenerali Jackson atë që pretendohet se është thënë
2 në këtë që do të shohim në këtë dokument.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim faqen 22 në PDF

4 PY. Kjo është dëshmia që ka dhënë Gjenerali Jackson në 2016
5 në një gjykatë britanike.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Rreshti 6.

7 PY. Mund ta shikoni më lart ju lutem. Mund ta shikoni numrin
8 në anë.

9 Ai thotë:

10 "... ta lëmë mënjanë atë çka mendoja unë që ishte një
11 mundësi e ulët por jo zero, që serbët të rifillonin
12 kundërsulmet ..."

13 Pra, ua ka raportuar Gjenerali Jackson po ashtu këtë që
14 ai mendonte që ishte një mundësi e ulët po nuk mund të thuhej
15 që ishte zero mundësia që ata të rifillonin luftimet?

16 PË. Jo, në fakt. Ky ishte një karakterizim i drejtë. Ky ishte
17 opinionin e tij. Unë kisha përgjegjësi të tjera, unë e merrja
18 më seriozisht kërcënimin e serbëve, se mund të luftonin apo
19 mund të mos luftonin.

20 PY. Por ua ka dhënë këtë informacion edhe ju ndihmoi ju që të
21 dilnit në përfundimet tuaja sa i takon gjasës për rifillimin e
22 luftimeve.

23 PË. Po, ma ka dhënë.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Meqë jemi te dokumenti në fjalë,
25 shohim faqen 16 në PDF.

1 PY. Dhe do t'ju pyes nëse ua ka raportuar Gjenerali Jackson
2 të njëjtën gjë që ka thënë përpara Gjykatës këtu.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Fillon rreshti 4.

4 PY. Është bërë pyetja:

5 "... a pajtoheni se ishin shënjestër e UÇK-së?"

6 Ai thotë:

7 "Po. Unë vetë nuk kisha prova pasi unë mendoj që ju
8 mendoni se unë kam prova. Më falni nëse u dhashë mesazhin e
9 gabuar. Po nga pikëpamja institucionale UÇK-ja në bazë të
10 politikave po kryenin akte terroriste ndaj çdo personi. Unë
11 nuk po them që nuk e kanë bërë këtë individët. Ka pasur
12 individë që e kanë bërë, por unë nuk kam asnjë provë që kjo të
13 ketë qenë praktikë e UÇK-së."

14 PË. Po, ma ka thënë edhe mua, Jackson të njëjtën gjë.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim faqen 21 tani në PDF.

16 PY. I është bërë pyetje nga pala kundërshtare - në fund, ju
17 lutem - fillojmë me rreshtin 13:

18 "A e dinit ju çfarë mund të bënit për të parandaluar UÇK-
19 në, në mos pjesërisht tërësisht, që të silleshin në mënyrë të
20 tillë?

21 Përgjigje:

22 "Është një pyetje shumë e përbërë."

23 Pastaj vazhdon:

24 "Më vjen keq, po mund të jetë."

25 Dhe ai thotë dhe ai vazhdon dhe thotë:

1 "Po ju them nuk kam asnjë provë që UÇK-ja si institucion
2 të ketë pasur një praktikë të spastrimit etnik të serbëve që
3 kishin mbetur në atë vend."

4 Ua ka raportuar dhe ju Gjenerali Jackson të njëjtën gjë?
5 PË. Po, por dua të lexoni pak rreshtin 20. Lexoni rreshtin 20
6 sepse këtë jam përpjekur të them unë mbase jo kaq bukur sa
7 këtu, po kam dy ditë që përpiqem të jap këtë mesazh.

8 PY. Po e lexoj unë. Ai thotë:

9 "E di, 99 për qind e dinë se persona individuale të UÇK-
10 së në fakt kanë qenë tërësisht jashtë kontrollit."

11 Ua ka raportuar dhe ju të njëjtën gjë dhe ju çoi në
12 vlerësimin tuaj se s'ka pasur komandë dhe kontroll të
13 mirëfilltë?

14 PË. Po.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim tani faqen 22 në PDF. Në
16 fund të faqes.

17 PY. Është pyetur për raportin e Marty. Keni dëgjuar për
18 raportin e Marty, Gjeneral, keni dëgjuar për raportin e Marty?

19 PË. Jo.

20 PY. I është bërë pyetje:

21 "Dhe dua të fokusohemi te UÇK-ja dhe po fokusohem në
22 konstatimet e Senator Marty?"

23 Ai përgjigjet:

24 "Po filloni të nënkuptoni tani që kjo ka qenë praktikë e
25 UÇK-së" - kalojmë në faqen tjetër - "dhe unë nuk pajtohem me

1 ju për këtë."

2 A përputhet kjo me atë çka ju ka raportuar Gjenerali
3 Jackson që UÇK-ja nuk kishte ndonjë praktikë?

4 Z. HALLING: [Përkthim] Ju lexojeni tamam sepse thuhet
5 "praktikë e UÇK-së për të spastruar çdo serb që kishte mbetur
6 në Kosovë".

7 DËSHMITARI: [Përkthim] Jo, nuk ka qenë praktikë e UÇK-së.
8 Po të shohim pak faqen pararendëse ose të flasim për faqen
9 pararendëse. E kam thënë të paktën dhjetë herë deri tani. Ka
10 qenë një situatë e tmerrshme për këta persona kishin frikë për
11 jetën e tyre. Ishin të inatosur, donin të merrnin hak. Kjo
12 është krejt normale. Dhe Jackson e ka thënë shumë bukur këtu
13 për Ballkanin që janë sy për sy e dhëmbë për dhëmbë, kanë një
14 praktikë, pra, sy për sy e dhëmbë për dhëmbë. Këto janë
15 situata normale.

16 Z. MISETIC: [Përkthim]

17 PY. Gjeneral, ju treguan disa dëshmi të Klaus Naumann përpara
18 TPNJ-së.

19 PË. Naumann, Naumann.

20 PY. Okej. Naumann. Ju kujtohet kjo dëshmi?

21 PË. Po.

22 PY. Do t'ju tregoj disa pjesë që nuk ua tregoi Prokurori.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim në ekran SPOE00406441 deri
24 në 00406504.

25 PY. Dua t'jua tregoj se kam përshtypjen që ju keqorientuan

1 duke mos ju treguar këtë pjesë që duhet ta shohim bashkë.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim faqen SPOE00406464. Shohim
3 rreshtin 6.

4 PY. Është bërë pyetja:

5 "Pra, Gjeneral," jo ju, Naumann:

6 "Gjeneral, pra, nëse e kuptoj unë, pjesë e problemit, siç
7 e shihni, është se NATO më përpara e kishte deklaruar UÇK-në
8 një grup terrorist. Sipas vetë rregullave të NATO-s ju nuk
9 mund të negocionit me ta apo të diskutonit me ta?"

10 Ai i është përgjigjur:

11 "Po, kështu është. Ju duhet t'u kërkonit kombeve
12 individualisht që t'i kontaktonin ata."

13 Pra, Gjenerali Naumann nuk po thotë që s'ka pasur
14 kontakt. Po ai ka thënë s'ka kaluar përmes NATO-s kontakti po
15 përmes shteteve anëtare individuale të NATO-s, saktë?

16 PË. Saktë.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë tek faqja pararendëse në
18 këtë dokument, këtu e ndaloj Prokurori leximin. Kështu që unë
19 dua të shkojmë poshtë dhe të shohim rreshtin 19.

20 PY. Ky është porcioni, pjesa që ua lexoi Prokurori kur:

21 "... folët për thembrën e Akilit ..."

22 Tani të shohim rreshtin 6 më poshtë, ai vijon, këtë nuk
23 ua lexoj Prokurori dhe thotë:

24 "Nuk kishim asnjë instrument për të kontrolluar ne UÇK-
25 në. U përpoqëm ta bënim. U përpoqëm t'u kërkonim kombeve

1 anëtare, shteteve anëtare të NATO-s që të kontaktonin përmes
2 njerëzve që kishin kontakte të më hershme. Por instrumenti që
3 u përdor në rastin e jugosllavëve, konkretisht për t'i
4 kërcënuar me masa ushtarake, nuk mund të zbatohet për
5 kosovarët."

6 Pra, a thuhet dhe një herë këtu dhe a është e vërtetë që
7 është bërë kontakti përmes shteteve individuale të NATO?

8 PË. Po, po. Ka pasur kontakte patjetër.

9 PY. Ju treguam një pjesë të shënimeve të Gjeneralit Reinhardt
10 i marsit 2000. A ju kujtohet?

11 PË. Po.

12 PY. Data e këtij shënimi është 10 mars 2000. Dhe unë dua t'ju
13 tregoj një artikull të *The New York Times* që ka raportuar për
14 këtë lloj ngjarje më 11 mars 2000.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] shohim në ekran 1D00181 e keni në
16 listën e materialeve që sapo nxorëm.

17 PY. E shihni këtu thotë, "Shefi i NATO-s në Kosovë ka frikë
18 se mos ka një vrull apo një vërshim përmes kufirit" dhe thotë:

19 "Komandanti i forcave paqeruajtëse në Kosovë me ish-
20 drejtuesin politik të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që është
21 shpërbërë përkrah tij u betua sot që do të ndalonte çdo akt
22 dhune që do të kryhej në Kosovë kundër Serbisë.

23 "Gjeneral Klaus Reinhardt ishte pranë Hashim Thaçit,
24 drejtuesit shqiptar. Paraqitja apo ajo që ju kërkua z. Thaçi
25 të bënte për Gjeneralin Wesley Clark, Komandantit Suprem të

1 NATO-s, ishte një përpjekje pët të përcjellë një mesazh
2 politik popullsisë së Kosovës dhe përtej madje dhe Serbisë.”

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë më poshtë në faqen tjetër.
4 Poshtë.

5 PY. Aty ku thuhet “Z. Thaçi ...” Thotë:

6 “Z. Thaçi dhe drejtuesit e TMK-së, struktura civile që ka
7 zëvendësuar Ushtrinë Çlirimtare, po dëgjojnë dhe po marrin
8 qëndrimet e duhura të përshtatshme publike. Në një intervistë
9 këtë javë pas një takimi në Kosovë me Gjeneralin Clark, z.
10 Thaçi e bëri të qartë dhe tha se kur lugina e Preshevës, një
11 zonë ku kishte kryesisht popullsi shqiptare që dikur ishin
12 pjesë e Kosovës, nuk ishte shqetësimi i tij.”

13 Ai tha:

14 “‘Unë respektoj të drejtat e shqiptarëve në Preshevë. Ata
15 duhet të kenë të drejtat e çdo qytetari demokratik. Por ne në
16 Kosovë jemi në rrethana të ndryshme dhe duhet të ndjekim një
17 qasje ndryshe për rajonin tonë’, tha ai. ‘Tani si president,
18 si kryetar i partisë politike në Kosovë shqetësimi im është
19 vetëm territori i Kosovës.’”

20 “Ai ka theksuar se shqiptarët nuk e donin dhunën. ‘Më
21 shumë se kushdo tjetër në rajon e dinë mirë shqiptarët se
22 çfarë është dhuna’”, tha ai.

23 Një çast, ju lutem që të përfundojnë përkthyesit.

24 Do ju bëj pyetjen dhe pastaj komentoni.

25 Pra, këtu thuhet që keni qenë një person që e keni

1 inkurajuar z. Thaçi të përcillte mesazhe politike. Ajo që
2 thuhet këtu a është në përputhje me mesazhin që keni kërkuar
3 ju të përcillet?

4 PË. Ajo që ka thënë po përputhet, po mbase s'ka thënë gjërat
5 e duhura me Klaus Reinhardt.

6 PY. Në rregull.

7 PË. Dua të them diçka. "Ramush Haradinaj që ka qenë një
8 komandant i fuqishëm ishte më i pavarur si natyrë" e lexova
9 aty, pikërisht kjo është përshtypja ime dhe prandaj dola unë
10 në konkluzione sa i takon komandës dhe kontrollit si ka
11 funksionuar komanda dhe kontrolli në UÇK. Këta ishin
12 personalitete të forta, persona që kanë rrezikuar jetën, jeta
13 e familjeve të tyre varej prej vendimeve të tyre. Këta nuk
14 ishin vartës të mirëfilltë. Nuk ekzistonte strukturë komande
15 dhe kontrolli. Ishin persona që luftonin për jetën gjatë
16 fushatës ajrore të NATO-s edhe këtë qëndrim e mbajtën edhe pas
17 fushatës ajrore. Prandaj Jackson e pati të vështirë me këta
18 persona, me këta individë, prandaj kishte akte hakmarrëse,
19 prandaj persona të caktuar mund të kenë kryer akte dhune ndaj
20 serbëve. Nuk ka dyshime për këtë.

21 PY. Në rregull. Gjeneral, javën e kaluar Ambasadori
22 Christopher Hill dha dëshmi dhe tha se asnjëherë nuk është
23 konsideruar UÇK-ja si organizatë terroriste e huaj nga Shtetet
24 e Bashkuara. A përputhet me ju?

25 PË. Ua thashë edhe më herët. Dikush e bëri këtë deklaratë dhe

1 ky person u qortua për këtë dhe u tërhoq nga Shtetet e

2 Bashkuara një deklaratë e tillë.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Më jepni një çast, ju lutem.

4 I nderuar Kryegjykatës, më thanë që në transkript në
5 rreshtin 11, fjalia e parë është pak e paqartë, mund të jetë
6 zbardhur gabim. Ta pyes dëshmitarin ta përsërisë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

8 Z. MISETIC: [Përkthim]

9 PY. Gjeneral, ju përmendët Ramush Haradinaj dhe *The New York*
10 *Times* dhe sipas transkriptit ju keni thënë:

11 "... por unë lexova fjalinë e fundit që nuk është
12 relevante për aspektet që po diskutojmë këtu ..."

13 Dëshët të thoshit "relevante" apo "jorelevante"?

14 PË. Nëse kam thënë jorelevante e kam thënë pa dashje.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo tha
16 "relevante". Janë relevante tha.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull. Thjesht për të
18 korrigjuar transkriptin.

19 PY. Gjenerali Clark, do të shikojmë disa pjesë të librit tuaj
20 që ua ka treguar edhe Prokurori.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim në ekran -- më falni ta
22 verifikoj pak numrin.

23 Shohim faqen DHT11103 deri në DHT111632. Libri juaj "Të
24 luftosh në kohëra moderne një luftë moderne", ndërkohë juve ju
25 kanë treguar një faqe të librit nga ana e Prokurorisë me numër

1 DHT11473.

2 PY. Këta ta shohim dhe dua që të na ndihmoni ju të
3 interpretojmë një fjali të cilën ua tregoi më herët Prokurori.
4 Në krye. Duhesh lexuar fjalia e dytë, ku thuhet:

5 "Hawk ishte në kontakt të drejtpërdrejtë me Ushtrinë
6 Shqiptare të cilët po ashtu po monitoronin UÇK-në dhe shumë
7 prej objektivave i përcilleshin CAOC-së."

8 Pyetja ime është kjo: Në këtë fjali thuhet që është
9 Ushtria Shqiptare ajo që i përcillte informacionet për
10 objektivat pasi monitoronte UÇK-në apo UÇK-ja kalonte
11 informacionin përmes Ushtrisë Shqiptare?

12 PË. Mbase kanë qenë pak të dyja. Por kishin kontakte të
13 drejtpërdrejta me pistën ajrore në Tiranë me Ushtrinë
14 Shqiptare. Ne nuk kishim asnjë mënyrë, ne, ne nuk mund ta
15 monitoronim UÇK-në, ne.

16 PY. Në fakt pyetja ime është kjo se është e paqartë mënyra se
17 si është shkruar këtu. Pra, është Ushtria Shqiptare ajo që e
18 merr informacionin prej UÇK-së por -- apo po e mbikëqyrnin ata
19 UÇK-në dhe Ushtria Shqiptare ju raporte ju?

20 PË. Fjalia është e mjegullt sepse situata ka qenë e mjegullt
21 sepse nuk ka qenë e qartë. Ngjarjet që jam përpjekur të
22 shpjegoj janë ngjarje, janë panorama që i kemi formuar shumë
23 shpejt gjatë fushatës ajrore gjatë kohës që ne negocionim.

24 Mike Jackson po ashtu negocionte. Unë isha më i shqetësuar që
25 të sillja B-52 në Pashtrik për të siguruar që s'do të kishim

1 probleme nga Milosheviqi. Pra, informacioni vinte nga të
2 gjitha anët.

3 Po sikurse ua shpjegova, ajo që ishte e pranishme gjatë
4 kohës që ndodhi fushata nuk ka qenë aty para 78 ditësh.
5 PY. E kuptova.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani shkojmë në faqen e librit me
7 numër DHT11419. Një çast, ju lutem.

8 I lutem Sekretarit të seancës të vendosë në ekran faqen
9 me numër DHT11419. Dua të shikojmë fjalinë që fillon "Ndërkohë
10 kur më pyetën ..." Nuk e shohim.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Besoj se kjo është një nga faqet
12 që është kërkuar të pranohet përmes mocionit për provat jo
13 gojore dhe nuk kemi kundërshtime.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

15 PY. Është paragrafi ku thotë këtu:

16 "U përpoqëm të krijojmë një sistem dhe të përdornim
17 raportet nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës për të na ndihmuar
18 ne të kuptonim se në cilat fshatra nuk kishte më kosovarë.
19 Ideja ishte që UÇK-ja të na thoshte nëpërmjet ndërmjetësve
20 nëse disa fshatra ishin të papushtuar. Ne shumë shpejt zbuluam
21 që kjo metodë s'ishte e besueshme. Informacioni i UÇK-së ose
22 ishte shumë i vjetruar ose serbët mund të kishin infiltruar
23 përmes linjave të tyre të komunikimit ose nuk ishte aq e saktë
24 saç na nevojitej ne. Kisha sugjeruar që ky sistem të mos
25 ndiqej më. Duhej të mbështeteshim kryesisht në televizion, nga

1 lajmet apo nga mjetet ajrore që kishim ne që të mos vrisnim
2 civilë dhe të mos godisnim fshatrat padrejtësisht.”

3 Pra, a përputhet kjo me atë që thatë për cilësinë e
4 informacioni që merrnit prej UÇK-së?

5 PË. Po.

6 PY. Pra, a përputhet kjo me faktin që nuk ka pasur komandë e
7 kontroll në UÇK?

8 PË. Sepse s’kishim formë efikase për të marrë -- nuk kishim
9 asnjë mënyrë efektive për të marrë informacion nga terreni që
10 më pas të na e përcillnin ne.

11 Ne kishim copëza informacioni. Të besueshme apo jo. Ua
12 thashë më herët, teksa vazhdonte fushata ajrore dhe ofensivat
13 fokusoheshin në zonën e Pashtrikut, për ne u bë e lehtë që të
14 merrnim informacion sepse kishim ne mbikëqyrje apo kontakte
15 fizike më të drejtpërdrejta. Por në zonat kur po përpiqeshim
16 të godisnim forcat serbe si në Drenicë dhe më tej Gjilani,
17 atje kishte persona përfaqësues të UÇK-së. Unë nuk e di kush
18 ishin. E dimë që kishte miq atje, e dimë që kishte armiq atje.
19 Mund të shikonim një tank që futej në një zonë drejt një
20 liqeni. Pra, përpiqeshim t’i shpjegonim pilotit çfarë po
21 shihnim ne. Por ishte shumë e vështirë, ishte gati e pamundur.
22 Pra, ishim në një situatë të paqartë prandaj përpiqeshim që të
23 merrnim informacione prej UÇK-së. Por informacioni prej tyre
24 nuk ishte i besueshëm deri në momentin që shkua në Malin e
25 Pashtrikut. Vetëm në ato momente u bë më e qartë, domethënë,

Dëshmitari: Wesley Clark (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Misetic

Faqe 115

1 por deri në ato momente ne nuk merrnim informacion të
2 besueshëm.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe sa pyetje
4 keni?

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Do konsultohem pak me klientin tim
6 dhe do ju them nëse kam ende nevojë për kohë apo jo.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
8 presim që të mbaroni tani apo nëse doni të bëjmë pushimin,
9 bëjmë pushimin.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Më lejoni një çast të flas pak me
11 klientin tim. Por ndërkohë dua të kërkoj të pranohet faqja që
12 trajtova me Gjeneralin.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Cila faqe
14 është kjo? 419?

15 Ka kundërshtime?

16 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, nuk kam kundërshtime. Por
17 mendoj që duhet t'i shtohet provës që ka marrë numrin P04514.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
19 Pranohet dhe do t'i bashkëngjitet provës materiale ekzistuese.

20 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Në rregulla atëherë.
21 Materiali do t'i bashkëngjitet provës P04514 dhe klasifikimi
22 është publik. Faleminderit.

23 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

24 Z. MISETIC: [Përkthim]

25 PY. Faleminderit, Gjeneral Clark.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë me kaq mbyll pyetjet e mia.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

3 Keni pyetje ju?

4 Gjykatësi Gaynor?

5 Gjeneral, do ju bëhet qejfi që po ju them se përfunduat
6 me ne. U bënë pyetjet e fundit. Jeni i lirë të shkoni, mund të
7 largoheni nga salla e gjyqit. Ju faleminderit që erdhët, që
8 ndatë informacionin që kishit me ne. Mund të largoheni me
9 Sekretarin e seancës.

10 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit. Po nuk pata një
11 shans -- më premtuat që mund të thoja diçka, nuk më dhatë
12 mundësinë që të thoja diçka.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni thënë
14 plot.

15 DËSHMITARI: [Përkthim] Më jepni vetëm dy minuta, ju
16 lutem. Do them diçka nga perspektiva ime.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nëse thoni
18 diçka nuk mund t'ju bëhen pyetje për këtë.

19 DËSHMITARI: [Përkthim] Nuk do them asgjë që ka nevojë të
20 pyetet më pas. Po dua t'ju jap thjesht një perspektivë.

21 Se përmenda Revolucionin Amerikan disa herë. Jemi në një
22 epokë aktualisht ku ka forca të mëdha që përpiqen të ndikojnë
23 qeveritë e ndryshme. Që prej Luftës së Dytë Botërore jemi
24 përpjekur që të kemi një sistem ndërkombëtar bazuar në
25 rregulla, që ka funksionuar deri në një masë por nuk ka

1 funksionuar tërësisht. Dhe pas rënies së murit të Berlinit dhe
2 hapjes së lindjes, u shpërbë Jugosllavia dhe personat në
3 Jugosllavi kërkuan të njëjtat liri sikurse perëndimi.
4 Sigurisht, kjo ka filluar që me monarkinë e Hasburgëve dhe
5 sovjetikëve dhe kemi një situatë aktualisht në Ukrainë.

6 Nuk po përpiqem të jem i pasjellshëm, se proceset penale
7 janë të rëndësishme. Por duhet të ketë një kufi duke
8 [Fonetikisht] sa i takon rendit, pra, ka rend por personat
9 duhet të respektohen dhe do përpiqen të luftojnë dhe për të
10 drejtat e tyre dhe këtë u përpoq të bënte UÇK-ja në fillimin e
11 viteve 1990 kur thjesht nuk pranuan shtypjen prej serbëve dhe
12 bënë të pamundurën për t'i rezistuar shtypjes prej serbëve.
13 Pra, ata nuk janë terroristë, pavarësisht se kur shkova të
14 takoja unë gjeneralët serbë ata më thanë po ata janë
15 terroristë. Ata nuk janë terroristë, janë njerëz që luftonin
16 kundër një regjimi të padrejtë, i jashtëligjshëm i cili
17 meritonte të largohej e të zëvendësohej.

18 E njëjta gjë po ndodh aktualisht në Ukrainë dhe mund të
19 vazhdojë edhe më tej. Dhe mendoj se kjo është shumë e vështirë
20 për jurisprudencën e gjykatave aktualisht. Sepse në një
21 moment, kemi jurisprudencën e Gjermanisë. Edhe në Gjermani
22 kemi një qeveri demokratike. Këtu kemi persona që luftuan për
23 lirinë e tyre.

24 Pra, ligjet, procedurat e shoqërive moderne duhet të
25 kuptojnë edhe nevojat e personave, personave që luftojnë për

1 lirinë e tyre dhe për dinjitetin e tyre. Kështu filloi
2 revolucionin në Shtetet e Bashkuara prandaj e kam përmendur kaq
3 shumë herë dhe ata patriotë amerikanë në 1775, 1774, po ashtu
4 u konsideruan terroristë pikërisht nga britanikët siç ndodhi
5 me amerikanët. Por Amerika u kthye një shtet madhështor.

6 Duhet t'i kemi parasysh të shkuarën, historinë, duhet të
7 shikoni çfarë po ndodh në Ukrainë, mbase do ketë dhe procese
8 për Ukrainën të ngjashme, po është e rëndësishme të kuptoni
9 rrethanat dhe kush mban përgjegjësi penale dhe se ka aspekte
10 më të larta strategjike që ndonjëherë kanë epërsi edhe që
11 shkojnë përtej mundësive të një individi të vetëm.

12 Faleminderit që më dhatë mundësinë ta shpjegoja. Ky është
13 mendimi im. E kam ndjekur këtë gjykim dhe i qëndroj bindjes së
14 mëparshme që Hashim Thaçi nuk është përgjegjës për atë çka ka
15 ndodhur në Kosovë, ai nuk mban përgjegjësi për aktet
16 individuale të dhunës dhe të hakmarrjes.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
18 Faleminderit që ishit këtu me ne.

19 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

20 [Dëshmitari largohet]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
22 përfaqësueses të Shteteve të Bashkuara të Amerikës që ishit e
23 pranishme. Mund të largoheni edhe ju nga salla e gjyqit nëse
24 dëshironi. Se pjesa tani do jetë goxha e mërzitshme. Në fakt i
25 gjithë procesi në vetvete.

1 Kemi një konferencë për ecurinë e çështjes nesër. Ne
2 menduam që do të kishim në fakt dëshmitarin paradite.
3 Konferencën e kemi nesër në orën 2.00 dhe do të jetë vetëm një
4 orë.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] A është e mundur ta bëjmë më
6 herët? Nëse është e mundur.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Fatkeqësisht
8 nuk mund ta bëjmë më herët do ta kemi në orën 2.00
9 konferencën.

10 Z. Ellis.

11 Z. ELLIS: [Përkthim] Është e mundur -- s'e kam pyetur z.
12 Krasniqi, po nëse z. Krasniqi dhe të bashkakuzuarit
13 dëshirojnë, mund ta ndjekin përmes videolidhjes nga njësia e
14 paraburgimit.

15 Më falni se s'kam zë. Desha t'ju pyesja nëse është e
16 mundur që z. Krasniqi ta ndjekë konferencën për ecurinë e
17 çështjes nga objekti i paraburgimit? Nuk e kam pyetur por
18 paraprakisht.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të gjithë të
20 akuzuarit nëse dëshirojnë mund ta ndjekin nga objekti i
21 paraburgimit. Nuk kemi kundërshtim për këtë.

22 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
24 Shihemi nesër në orën 2.00.

25 --- Seanca mbyllet në orën 13.10